



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCËS
AGJENCIA KOMBËTARE E PROVIMEVE**

Pyetje për historinë dhe shtetin:

Pyetja 1

Rregullat dhe ligjet në demokraci :

- A) Hartohen për të përmbushur interes e grupeve më të pasura të shoqërisë;
- B) Hartohen sipas vullnetit dhe dëshirës të kryetarit të shtetit;
- C) Janë të pandryshueshme;
- D) Ndryshojnë duke zbatuar të drejtën e individit për vendimmarrje.

Pyetja 2

Shoqëria greke e periudhës homerike ishte:

- A) Primitive;
- B) Kalimtare (në shthurje e sipër të rendit gjinor);
- C) Tipike skllavopronare;
- D) Skllavopronare në shthurje.

Pyetja 3

Burimi kryesor i skllavërisë në Greqi në periudhën homerike ishte:

- A) Lufta dhe grabitja;
- B) Mosshlyerja e borxheve;
- C) Blerja e skllavëve;
- D) Të treja.

Pyetja 4

Cili nga organet drejtuese të poshtëshënuara i përket Greqisë së periudhës homerike:

- A) Mbreti;
- B) Këshilli i pleqëve;
- C) Mbledhja popullore;
- D) Të trija së bashku.

Pyetja 5

Shkaqet e krijimit të ngulimeve greke jashtë territorit të Greqisë së vjetër ishin:

- A) Fushatat ushtarake;
- B) Konfliktet fetare;
- C) Faktorët ekonomikë dhe politikë;
- D) Të trija së bashku.

Pyetja 6

Kolonizimi grek në shekujt VIII - VI p.k u shoqërua:

- A) Me konflikte të armatosura;
- B) Me ngadalsimin e zhvillimit të Greqisë së Vjetër;
- C) Me zhvillimin e tregtisë dhe përvetsimin e ndërsjelltë kulturor;
- D) Me asimilimin e popullsisë të atyre vendeve ku u vendosën.

Pyetja 7

Ligjet e Drakonit saksiononin:

- A) Barazinë e burrit me gruan;
- B) Liritë dhe të drejtat e skllëvërve;
- C) Mbrojtjen e pronës private;
- D) Mbrojtjen e organeve të rendit fisnor.

Pyetja 8

Në cilin nga pohimet e mëposhtme skllavi dallohej nga koloni:

- A) Ishte i lirë;
- B) Kishte familje;
- C) Zotëronte një pjesë të prodhimit;
- D) S'kishte asnjë të drejtë.

Pyetja 9

Në Kuvendin e Popullit në Athinën e Vjetër merrnin pjesë:

- A) Metekët;
- B) Qytetarët athinas;
- C) Skllëvërit;
- D) Të gjithë së bashku.

Pyetja 10

Kuvendi i Popullit (Eklelesia) në Athinën e Vjetër ushtronte pushtet:

- A) Politik;
- B) Legjislativ jo të plotë;
- C) Juridik i kufizuar;
- D) Të treja.

Pyetja 11

Anëtarët e Gjyqit të Jurisë (Jelieja) në kohën e Perikliut në Athinën e Vjetër zgjidheshin:

- A) Me votim të fshehtë;
- B) Me votim të hapur;
- C) Me konkurs, duke provuar njohuritë e tyre në provimin me shkrim;
- D) Me short.

Pyetja 12

Roli kryesor i qeverisjes në kohën e Perikliut në shtetin e Athinës i takonte:

- A) Kuvendit të Qytetarëve;
- B) Kuvendit të të Pesqindëve;
- C) Gjyqyt të Jurisë;
- D) Këshillit të Dhjetë Strategëve.

Pyetja 13

Monumentet më të vjetra të kulturës njerzore janë:

- A) Mitet dhe legjendat;
- B) Veglat e punës;
- C) Vizatimet e para në muret e shpellave;
- D) Skulpturat prej kocke dhe guri.

Pyetja 14

Forma e regjimit që u vendos në Shqipëri pas zgjedhjeve të 2 Dhjetorit u quajt Republikë:

- A) Popullore Socialiste;
- B) Parlamentare;

- C) Presidenciale;
- D) Popullore.

Pyetja 15

Sipas kushtetutës të vitit 1976 Shqipëria ishte Republikë:

- A) Popullore Socialiste;
- B) Parlamentare;
- C) Presidenciale;
- D) Popullore.

Pyetja 16

Shqipëria u bë anëtare e NATO-s në vitin:

- A) 1955;
- B) 1968;
- C) 1992;
- D) 2009.

Pyetja 17

Zgjedhjet pluraliste të vitit 1991 i fitoi Partia:

- A) Socialiste;
- B) Demokratike;
- C) Punës;
- D) Republikane.

Pyetja 18

NATO është një organizatë me karakter:

- A) Ushtarak;
- B) Politik;
- C) Politiko-ushtarak;
- D) Ekonomiko- social.

Pyetja 19

Presidenti i Republikës së Shqipërisë :

- A) Zgjidhet drejtpërdrejt nga populli;

- B) Emërohet nga Partia që fiton zgjedhjet;
- C) Zgjidhet nga Kuvendi i Shqipërisë;
- D) Zgjidhet çdo shtetas shqiptar që ka mbushur moshën 18 vjeç.

Pyetja 20

Shqipëria është:

- A) Republikë parlamentare;
- B) Republikë gjysëmparlamentare;
- C) Republikë presidenciale;
- D) Monarki Parlamentare.

Pyetja 21

Drejtimi i shtetit me dorë të forte nga një njeri është tipar karakteristik për:

- A) Monarkinë parlamentare;
- B) Monarkinë kushtetuese;
- C) Republikën presidenciale;
- D) Sistemin totalitar.

Pyetja 22

Monarku në Monarkinë kushtetuese:

- A) Ushtron pushtet të pakufizuar;
- B) Harton dhe miraton ligjet;
- C) Ushtron pushtet të kufizuar;
- D) Gjykon mbi çështje të ndryshme.

Pyetja 23

Në Republikën e Shqipërisë pushteti gjyqësor ushtrohet nga:

- A) Gjykata e Lartë, si dhe nga gjykatat e apelit e gjykatat e shkallës së parë;
- B) Ministria e drejtësisë;
- C) Kuvendi i Shqipërisë;
- D) Këshilli i Lartë i Drejtësisë.

Pyetja 24

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve ndërmjet pushtetit legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor është kompetencë:

- A) E Kuvendit të Shqipërisë;

- B) E Gjykatës kushtetuese;
- C) E Këshillit të Lartë të Drejtësisë;
- D) E Avokatit të Popullit.

Pyetja 25

Në Republikën e Shqipërisë organi më i lartë ligjvënës është:

- A) Gjykata Kushtetuese;
- B) Gjykata e Lartë;
- C) Kuvendi;
- D) Institucioni i presidentit.

Pyetja 26

Zgjidhja përfundimtare e ankesave të shtetasëve për zbatimin e të drejtave dhe lirive të tyre themelore është kompetencë:

- A) E Komitetit Shqiptar të Helsinkit;
- B) E Gjykatës Kushtetuese;
- C) E Këshillit të Lartë të Drejtësisë;
- D) E Avokatit të Popullit.

Pyetja 27

Hartimi, diskutimi dhe miratimi i ligjeve është kompetencë:

- A) E Gjykatës Kushtetuese;
- B) E Gjykatës së Lartë;
- C) E presidentit;
- D) E Kuvendit.

Pyetja 28

Në Republikën e Shqipërisë pushteti ekzekutiv realizohet:

- A) Nga organet qendrore dhe vendore;
- B) Vetëm nga organet qendrore;
- C) Nga presidenti;
- D) Nga Kuvendi.

Pyetje 29

Kodi i Hamurabit synonte:

- A) Forcimin e shtetit;

- B) Vendosjen e marrëdhënive me shtetasit;
- C) Përcaktimin e detyrimeve të shtetasve;
- D) Të tria së bashku.

Pyetje 30

Sundimi oligarkik është sundimi:

- A) I një personi;
- B) I një grupi personash;
- C) I popullsisë së lirë;
- D) I klasës skllavopronare.

Pyetje 31

Parlamenti lindi

- A) Në Angli;
- B) Në SHBA;
- C) Në Itali;
- D) Në Greqi.

Pyetja 32

Ligjet e 12 tabelave janë hartuar në:

- A) Romën e Vjetër;
- B) Kinen e Vjetër;
- C) Persi;
- D) Indi.

Pyetja 33

Ligjet e Likurgut janë hartuar në:

- A) Romën e Vjetër;
- B) Kinen e Vjetër;
- C) Greqinë e Vjetër;
- D) Indi.

Pyetje për kulturën dhe fenë (34-86)

Pyetja 34

Traditat dhe zakonet:

- A) Janë rregulla sjelljeje të pandryshueshme;
- B) Janë rregulla sjelljeje të detyrueshme për të gjithë shtetasit;
- C) Shërbejnë si rregulla sjelljeje në grupe më të vogla shoqërore;
- D) Rregulla penguese për veprimtarinë e individëve në shoqëri.

Pyetja 35

Forma më e përhapur e martesës në shoqërinë e sotme shqiptare është:

- A) Monogamia seriale;
- B) Monogamia;
- C) Poliandria;
- D) Poliginia.

Pyetje 36

Lindja e krishterimit ishte:

- A) Sajesë e filozofëve romakë të lidhur me pushtetin;
- B) Rezultati i mponimit të perandorëve romakë;
- C) Rezultat i rrethanave ekonomike dhe shoqërore;
- D) Të trija së bashku.

Pyetja 37

Qarko pohimin e saktë:

- A) Indentiteti i një individi formësohet përmes ndërveprimit me familjen e vet;
- B) Disa pjesë të indentitetit të një individi janë të lindura;
- C) Disa pjesë të indentitetit të një individi janë të mësuara;
- D) Të trija së bashku.

Pyetja 38

Qarko pohimin e saktë:

- A) Ndryshimi përreth nesh është sasior dhe cilësor;
- B) Ndryshimi është vetëm pozitiv;
- C) Ndryshimi prek vetëm individitet dhe jo kombet.
- D) Të trija së bashku.

Pyetja 39

Qarko pohimin e saktë:

- A) Ndryshimi përreth nesh është sasior dhe cilësor;
- B) Ndryshimi është pozitiv dhe negativ;
- C) Ndryshimi prek individitet dhe kombet.
- D) Të trija së bashku.

Pyetja 40

Në shoqërinë bashkëkohore nënkulturat kryesore përcaktohen nga:

- A) Klasat shoqërore;
- B) Përkatësia etnike;
- C) Profesionet;
- D) Të trija së bashku.

Pyetja 41

Termi “Simboli kulturor” tregon:

- A) Diçka që përçon një kuptim të caktuar;
- B) Një marrdhënie mes njerzëve;
- C) Kriteria vlerësimi;
- D) Të trija së bashku.

Pyetja 42

Gjeni pohimin e saktë:

- A) Simbolet kulturore nuk ndryshojnë në rrjedhën e kohës;
- B) Simbolet kulturore kanë kuptim të njejtë për të gjitha kulturat;
- C) Kultura të ndryshme kanë simbole të veçanta;
- D) Asnjëra prej tyre.

Pyetja 43

Embrion i besimit kristian u bë:

- A) Filozofia e lashtë greke;
- B) Filozofia e vjetër romake;
- C) Besimet e lashta dhe feja e hebrenjve të vjetër;
- D) Të trija së bashku.

Pyetja 44

Karakteristikë për kristianizmin është:

- A) Besimi pagan;
- B) Besimi monoteist;
- C) Besimi animist;
- D) Besimi totemist.

Pyetja 45

Pse feja kristiane u përhap me shpejtësi dhe u përqaftua nga një numër i madh njerëzish:

- A) Njerëzit dëshironin një fe që të shpjegonte kuptimin e jetës dhe të ofronte udhëheqje morale;
- B) Premtonte lehtësim prej vuajtëve dhe padrejtësive në “jetën” pas vdekjes;
- C) Predikonte mesazhin e dashurisë universal dhe të vëllazërimit;
- D) Të treja.

Pyetja 46

Çfarë qëndrimi mbajtën autoritetet romake kur filluan të përhapen idetë e kristianizmit:

- A) Tolerant;
- B) Kundërshtues;
- C) Neutral;
- D) Përkrahën dhe nxitën përhapjen e tyre.

Pyetja 47

Feja islame lindi:

- A) Në Gadishullin Arabik;
- B) Në Gadishullin e Industanit;
- C) Në Gadishullin e Ballkanit;
- D) Në Gadishullin Iberik.

Pyetja 48

Cili nga personat e poshtshënuar është themelues i islamizmit:

- A) Asoka;
- B) Muhameti;
- C) Buda;
- D) Abu Bekr.

Pyetja 49

Karakteristikë për islamizmin është:

- A) Besimi monoteist;
- B) Besimi pagan;
- C) Besimi animist;
- D) Besimi totemist.

Pyetja 50

Feja islame:

- A) Është ndikuar nga jahudizmi;
- B) Është ndikuar nga krishterimi;
- C) Njeh Moisiun e Jezusin, por me ndryshimin se ata pranohen si profetë, si paraardhës të Muhametit;
- D) Të trija së bashku.

Pyetja 51

Sipas predikimeve të Muhametit njerëzit për të fituar shpëtimin duhet:

- A) Të prisnin ardhjen e Mesisë, i cili do të dërgohej nga perëndia për të zhdukur të keqen në tokë;
- B) Të mos hiqnin dorë nga besimi në shumë zotër;
- C) Të ndiqnin një kod të caktuar moral, në përputhje me mësimet e fesë islame;
- D) Të trija së bashku.

Pyetja 52

Kujt i kushtonte më tepër rëndësi Budizmi:

- A) Shpërnguljes së shpirtit;
- B) Mënyrës së jetesës;
- C) Kastës së cilës i përkiste njeriu;
- D) Ndëshkimit të njeriut për fajet e bëra në këtë botë.

Pyetja 53

Nismëtar i besimit budist ishte:

- A) Siddhartha Gautama;
- B) Zooroastro;
- C) Moisiu;
- D) Asoka.

Pyetja 54

Idetë e tij Buda i paraqiti:

- A) Në “Librin e zbulesës”;
- B) Si rregulla morale në trajtën e ligjeve, të cilat u bënë të njohura, si “Dhjetë porositë”;
- C) Në ediktet e Asokës;
- D) Nëpërmjet “Katër të vërtetave fisnike”.

Pyetja 55

Ndarja e shoqërisë indiane në kasta:

- A) Ishte e ngurtë;
- B) Ndalohej kalimi nga njëra kastë tek tjetra;
- C) Nuk lejohej asnjë lidhje në mes tyre;
- D) Të trija së bashku.

Pyetja 56

Sipas predikimeve të Budës, shkaktar i të këqijave ishte:

- A) Qeverisja e keqe;
- B) Mjedisi gjeografik;
- C) Dëshira dhe përpjekjet e njerëzëve për një jetë më të mirë;
- D) Të treja.

Pyetja 57

Filozofia taoiste predikonte:

- A) Zbulimin e rrugës së universit dhe të jetuarit thjeshtë dhe në harmoni me natyrën;
- B) Besnikëri ndaj traditës dhe respektim të paraardhësve;
- C) Barazi, drejtësi dhe lumturi për të gjitha qeniet mbi tokë;
- D) Të treja.

Pyetja 58

Filozofia e Konfucit predikonte:

- A) Zbulimin e rrugës së universit dhe të jetuarit thjeshtë dhe në harmoni me natyrën;
- B) Besnikëri ndaj traditës dhe respektim të paraardhësve;
- C) Njerëzit janë qenie që kanë nevojë për një drejtim autoritar;
- D) Domdoshmëri për ndryshime rrënjësore në jetën shoqërore.

Pyetja 59

Feja e krishterë në fillimet e saj u perhap si:

- A) Sekt;
- B) Kult;
- C) Eklezi;
- D) Asnjë prej tyre.

Pyetja 60

Feja lidhet me:

- A) Besimin;
- B) Arsyetimin shkencor;
- C) Shekullarizimin;
- D) Asnjë prej tyre.

Pyetja 61

Parimi i humanizmit njihet me emrin xhente te:

- A) Krishterimi;
- B) Islamizmi;
- C) Konfucizmi;
- D) Hinduizmi.

Pyetja 62

Cila nga këto fe njihet si fe etike:

- A) Krishterimi;
- B) Islamizmi;
- C) Judaizmi;
- D) Budizmi.

Pyetja 63

Ideja e metamorfozës gjendet tek:

- A) Krishterimi;
- B) Islamizmi;
- C) Judaizmi;
- D) Hinduizmi.

Pyetja 64

Besimi tek shpirtërat si dashamirës apo shkaktarë të së keqes lidhet me:

- A) Animizmin;
- B) Totemizmin;
- C) Metamorfozën;
- D) Të treja.

Pyetja 65

Njeh dhe nderon një fuqi hyjnore të vetme:

- A) Krishterimi;
- B) Hinduizmi;
- C) Konfucizmi;
- D) Të treja.

Pyetja 66

Cila nga këto fe nuk lidhet me veprimtarinë e një njeriu të vetëm:

- A) Krishterimi;
- B) Hinduizmi;
- C) Konfucizmi;
- D) Islamizmi.

Pyetja 67

Cila nga këto fe nuk bën një dallim të qartë mes besimtarëve dhe jo besimtarëve:

- A) Krishterimi;
- B) Hinduizmi;
- C) Islamizmi;
- D) Të treja.

Pyetja 68

Gjendja e nirvanas predikohet nga:

- A) Hinduizmi;

- B) Judaizmi;
- C) Konfucizmi;
- D) Të treja.

Pyetja 69

Është fe monoteiste:

- A) Animizmi;
- B) Konfucizmi;
- C) Judaizmi;
- D) Budizmi.

Pyetja 70

Organizata fetare e lidhur zyrtarisht me shtetin quhet:

- A) Kult;
- B) Sekt;
- C) Eklezi;
- D) Dinominejshën.

Pyetja 71

Islamizmi në Shqipëri është përhapur si:

- A) Sekt;
- B) Kult;
- C) Dinominejshën;
- D) Eklezi.

Pyetja 72

Përplasja e hapur midis kishës Perëndimore dhe kishës Lindore ndodhi:

- A) Më 313;
- B) Më 1054;
- C) Më 1261;
- D) Më 1453.

Pyetja 73

Pse ndodhi ndarja e kristianizmit:

- A) Për çështjet e kontrollit të kishës;
- B) Për marrëdhëniet ndërmjet kishës (autoritetit shpirtëror) dhe autoritetit shtetëror;
- C) Për qëndrime të ndryshme në lidhje me kryerjen e cermonive fetare;
- D) Të tria së bashku.

Pyetja 74

Kristianizmi u nda:

- A) Në protestantizëm dhe katolicizëm;
- B) Në katolicizëm dhe budizëm;
- C) Në katolicizëm dhe ortodoksizëm;
- D) Në ortodoksizëm dhe bektashizëm.

Pyetja 75

Fushatat kryqtare gjatë Mesjetës u ndërmorën për shkaqe:

- A) Politike;
- B) Fetare;
- C) Tregtare;
- D) Të tria bashkë.

Pyetja 76

Fushatat kryqtare u organizuan dhe u drejtuan nga:

- A) Kisha katolike;
- B) Kisha ortodokse;
- C) Perandoria Gjermane;
- D) Të tria bashkë.

Pyetja 77

Cili nga perandorët e poshtëshënuar i persekutoi kristianët:

- A) Neroni, në vitin 64;
- B) Kostadini, në vitin 312;
- C) Teodosi, në vitin 380;
- D) Të tre.

Pyetja 78

Si konsiderohej perandori në Bizant:

- A) I shenjtë dhe adhurohej si perëndi;
- B) Si funksionari më i lartë i zgjedhur nga populli për të derjtuar vendin;
- C) Si njeriu më i ditur dhe i paanshëm;
- D) Të tria bashkë.

Pyetja 79

Si përcaktohej pozita e perandorit në legjislacionin bizantin:

- A) Zgjidhej nga populli dhe përgjigjej para tij për kryerjen e detyrës;
- B) Zgjidhej nga parlamenti dhe përgjigjej para tij për kryerjen e detyrës;
- C) Ishte i caktuar nga zoti dhe qëndronte në pushtet në saje të mbrojtjes nga pushteti hyjnor;
- D) Asnjëra nga këto të trija.

Pyetja 80

Kurani i ndalon myslimanët :

- A) Të pinë alkool;
- B) Të luajnë bixhoz;
- C) Të jenë të pandershëm dhe lakmitarë;
- D) Të tria bashkë.

Pyetja 81

Si quhet ikja e Muhametit nga Meka në Medinë:

- A) Haxhillëk;
- B) Hixhra;
- C) Besnikëri;
- D) Xhihad.

Pyetja 82

Cili nga vitet e poshtëshënura u quajt viti 1 në kalendarin mysliman:

- A) Viti 750, lindja e Muhametit;
- B) Viti 610, kur Muhameti mund të ketë nisur veprimtarinë si predikues;
- C) Viti 622, kur Muhameti u largua nga Meka;
- D) Viti 632, vdekja e Muhametit.

Pyetja 83

Feja myslimane u nda në dy sekte kryesore:

- A) Brahmanë dhe budistë;
- B) Puritanë e protestantë;
- C) Sunnitë e shiitë;
- D) Në asnjërën nga këto të trija.

Pyetja 84

Kërkesa e pasuesve të shiizmit ishte:

- A) Barazia e burrit me gruan në familje dhe shoqëri;
- B) Kalifi të zgjidhej nga bashkësia myslimane;
- C) Pretendonin se i vetmi pasardhës i drejtpërdrejtë i Aliut dhe i gruas së tij (vajzës së Muhametit) mund të bëhej kalif;
- D) Kalifi të ushtronte vetëm pushtet civil.

Pyetja 85

Cili ishte qëndrimi i Muhametit ndaj edukimit dhe mësimin:

- A) E nënvleftësonte mësimin dhe edukimin;
- B) U privonte të drejtën e arsimit të gjitha grave dhe vajzave;
- C) I dha përparësi edukimit dhe mësimin, duke thënë se “kërkimi i njohurive është një detyrë për çdo mysliman, burrë apo grua”;
- D) I dha përparësi vetëm mësimin të kuranit dhe i ndaloi myslimanët të mësonin shkencat e natyrës.

Pyetja 86

Çfarë kontributi kanë dhënë arabët në fushën e shkencave të natyrës:

- A) Përpunuan idenë e zeros dhe të numrave të huazuara nga India;
- B) U morën me algjebër dhe dhanë ide të reja në gjeometri dhe trigonometri;
- C) Arritën suksese në mjekësi, duke kuruar mjaftë sëmundje etj.;
- D) Të tria bashkë.

Pyetje për të Drejtat e Njeriut: (87-162)

Pyetja 87

Lidhja e Kombeve u formua për:

- A) Kufizimin ushtarak të shteteve të mëdha;
- B) Sigurimin dhe ruajtjen e tërësisë tokësore;
- C) Si kundërpeshë ndaj këshillit të Europës;
- D) Si kundërpeshë ndaj Bashkimit Europian.

Pyetja 88

Në qershor 1945 në San Francisko u themelua :

- A) Organizata e Kombeve të Bashkuara;
- B) Bashkimi Europian;
- C) NATO
- D) Organizata për Sigurimin dhe Bashkëpunimin Europian.

Pyetja 89

Dokumenti: Deklarata për parimet e marrëdhënie të ndërsjellta, për forcimin e besimit, sigurisë e çarmatimit u miratua nga:

- A) OKB-ja;
- B) Keshilli i Evropës;
- C) . Parlamenti Evropian;
- D) KSBE-ja.

Pyetja 90

Të drejtat civile janë:

- A) Mosdiskriminimi.
- B) Minimumi jetik.
- C) Përfshirja në punë publike.
- D) Të ardhura të mjaftueshme.

Pyetja 91

Të drejtat politike janë:

- A) Votimi.
- B) Të ardhura të mjaftueshme.
- C) E drejta për banim
- D) E drejta për arsim.

Pyetja 92

Të drejtat ekonomike janë

- A) Mbledhjet
- B) Mbrojtja nga shteti
- C) E drejta për punë
- D) Lëvizja e lirë.

Pyetja 93

Të drejtat sociale janë:

- A) Krijimi i sindikatave.
- B) Identiteti kulturor.
- C) Ushtrimi i zgjedhjeve.

D) Ushtrimi i traditave.

Pyetja 94

Një ndër Organizmat e O.K.B është:

- A) Komiteti i të drejtave të njeriut.
- B) Komiteti për të drejtat e fëmijve.
- C) Organizata botërore e ushqimit dhe bujqësisë.
- D) UNICEF

Pyetja 95

Një ndër agjencitë e specializuara të Kombeve të Bashkuara është:

- A) Organizata ndërkombëtare e punës.
- B) Komiteti për eliminimin e diskriminimit ndaj grave.
- C) Fondi për viktimat e torturës.
- D) PNUD

Pyetje 96

Ç'përfaqsonte pushteti i faraonit:

- A) Ishte përfaqësuesi më i lartë i klerit;
- B) Ishte gjykatës suprem;
- C) Ishte komandant i ushtrisë
- D) Të tria së bashku.

Pyetje 97

Karta e Madhe e Lirive në Angli shpalli:

- A) Forcimin e pushtetit mbretëror;
- B) Kufizimin e pushtetit mbretëror;
- C) Ndarjen e kishës nga shteti;
- D) Ndarjen e pushtetit.

Pyetje 98

Në vitin 1949 disa shtete të Europës Perëndimore themeluan në Londër:

- A) OKB-në;
- B) NATO;

- C) Këshillin e Europës;
- D) Tregun e Përbashkët European.

Pyetje 99

Organizata e Sigurimit dhe e Bashkëpunimit European (OSBE) u themelua:

- A) Në Bruksel më 1949;
- B) Në Romë më 1957;
- C) Në Berlin më 1972;
- D) Në Helsinki më 1975.

Pyetje 100

Disa vende të Europës Perëndimore dhe SHBA krijuan në prill 1949:

- A) Paktin Ushtarak të Atlantikut të Veriut;
- B) Bashkimin European;
- C) Organizatën për Sigurimin dhe Bashkëpunimin European;
- D) Fondin Monetar Ndërkombëtar (FMN).

Pyetje 101

Plani Marshall u hartua për të ndihmuar:

- A) Azinë;
- B) Amerikën Latine;
- C) Europën;
- D) Afrikën.

Pyetje 102

Të jesh anëtar i një komuniteti duhet:

- A) Të jeni miq;
- B) Të pëlqeni njeri-tjetrin;
- C) Të keni shije të ngjashme;
- D) Të jesh pjesë e diçkaje më të madhe se vetja.

Pyetje 103

Të jesh pjesë e një grupi duhet:

- A) Të kesh diçka të përbashkët me të tjerët në grup, një karakteristikë, interes etj;
- B) Të mos marrësh pjesë në grupe të tjera;

- C) Të kesh vetëm përfitime dhe asnjë përgjegjësi;
- D) Të mos jeni të ndërruarur nga njeri-tjetri.

Pyetje 104

Të ndërtosh një komunitet duhet:

- A) Të kesh tradita dhe zakone të njejt;
- B) Të kesh njohje dhe lidhje miqsore të mëparshme;
- C) Të shohësh vlera dhe partneritet te të tjerat;
- D) Të mos marrësh pjesë në komunitete të tjera.

Pyetje 105

Gjeni përgjigjen e saktë:

- A) Demokracia nënkupton barazinë ekonomike e politike të qytetarëve;
- B) Demokracia ushtrohet përmes pjesëmarrjes së popullit në qeverisje;
- C) Demokracia përfaqëson vetëm mbrojtjen e interesave të shumicës;
- D) Të trija së bashku.

Pyetje 106

Në shoqërinë demokratike çdo individ gëzon:

- A) Të drejtën e lirisë, barazisë dhe drejtësisë;
- B) Të drejtën të thotë lirisht fjalën e tij e ta mbrojë atë;
- C) Të drejtën të marrë pjesë edhe në marrjen e vendimeve;
- D) Të trija së bashku.

Pyetje 107

Në shoqërinë demokratike:

- A) Vendimi i shumicës është gjithmonë i drejtë;
- B) Ka edhe raste kur shumica nuk ka të drejtë për vendimin që merr;
- C) Vendimi i shumicës nuk gjykohet në asnjë rast, por është idetyrueshëm të zbatohet;
- D) Asnjëra prej tyre.

Pyetje 108

Gjeni përgjigjen e saktë:

- A) Sistemi politik është tërsia e institucioneve, grupeve të interesit;
- B) Sistemi politik është i përbërë nga anëtarë të organizatave sociale që kanë pushtetin;

C) Sistemet politike dallohen ndërmjet tyre nga mënyra evçantë e ushtrimit të pushtetit politik;

D) Të trija së bashku.

Pyetje 109

Agjencia e specializuar e Kombeve të Bashkuara është:

A) Organizata Botërore e Ushqimit dhe bujqësisë;

B) UNHCR;

C) PNUD;

D) UNICEF.

Pyetje 110

Agjencia e specializuar e Kombeve të Bashkuara është:

A) UNIFEM

B) UNFPA;

C) Organizata Botërore e Shëndetësisë;

D) UNEP.

Pyetja 111

Meknizëm i zbatimit të Kombeve të Bashkuara është:

A) FAO;

B) ILO;

C) Komiteti kundër torturës;

D) Instituti për trajtim dhe kërkim.

Pyetja 112

21 Shkurti është:

A) Dita botërore e meteorologjisë;

B) Dita botërore e shëndetit;

C) Dita botërore e ujit;

D) e gjuhës amtare.

Pyetja 113

21 Shtatori është:

A) Dita ndërkombëtare e paqes;

B) Dita botërore e banimit;

C) Dita botërore e mësuesit;

D) Dita botërore e detit.

Pyetja 114

9 Tetori është:

A) Dita botërore e ushqimit;

B) Dita botërore e postës;

- C) Dita ndërkombëtare e rinisë.
- D) Dita botërore pa duhan.

Pyetja 115

10 Dhjetori është:

- A) Dita e aviacionit civil ndërkombëtar;
- B) Dita e të drejtave të njeriut;
- C) Dita ndërkombëtare e emigracionit;
- D) Dita ndërkombëtare kundër SIDES

Pyetja 116

Anëtarët e përhershëm të Këshillit të Sigurimit janë:

- A) SHBA, Anglia, Franca, Rusia, Gjermania;
- B) SHBA, Anglia, Franca, Rusia, Kina;
- C) SHBA, Anglia, Rusia, Gjermania, Japonia, Kanadaja;
- D) SHBA, Anglia, Franca, Italia, Kina.

Pyetja 117

Paprekshmëria e personit, të drejtat dhe liritë e njeriut për herë të parë u shpallën në dokumentin:

- A) “E Drejta Romake”;
- B) “E Drejta Salike”;
- C) “Karta e Madhe e Lirive”;
- D) “Kodi i Justinianit”.

Pyetja 118

Numri i anëtarëve të përhershëm të Këshillit të Sigurimit është:

- A) Pesë;
- B) Shtatë;
- C) Njëmbëdhjetë;
- D) Pesëmbëdhjetë.

Pyetja 119

Sindikatat janë organizata me karakter:

- A) Politik;
- B) Ekonomik;
- C) Kulturor;
- D) Sportiv.

Pyetja 120

KSBE njihet e tillë deri në virtin:

- A) 1994;
- B) 1975;
- C) 1981;
- D) 1990

Pyetja 121

Lidhja e Kombeve është krijuar më:

- A) 1989;
- B) 1919;
- C) 1995;
- D) 2001

Pyetja 122

Sa shtet e kanë njohur dhe nënshkruar Deklaratën e OKB-së deri më 1945:

- A) 30 shtete;
- B) 42 shtete;
- C) 51 shtete;
- D) 10 shtete.

Pyetja 123

Sa shtete kanë njohur dhe nënshkruar Deklaratën e OKB-së deri më 1950:

- A) 51 shtet
- B) 40 shtete
- C) 54 shtete
- D) 60 shtete

Pyetja 124

Kur u pranua Shqipëria anëtare e OKB-së:

- A) 1945;
- B) 1950;
- C) 1955;
- D) 1960.

Pyetja 125

Kur u pranua Shqipëria anëtare e Lidhjes së Kombeve:

- A) 1919;
- B) 1920;
- C) 1923;
- D) 1925.

Pyetja 126

Konventa për të drejtat e fëmijëve ka hyrë në fuqi:

- A) 1980;
- B) 1990;
- C) 1992;
- D) 1995.

Pyetja 127

Konventa për të drejtat e fëmijëve përmban:

- A) 54 nene;
- B) 32 nene;
- C) 45 nene;
- D) 47 nene.

Pyetja 128

Kur e ratifikoi Shqipëria Konventën për të drejtat e fëmijëve:

- A) 1992;
- B) 1997;
- C) 1999;
- D) 2000.

Pyetja 129

Në fund të vitit 1999 Konventën për të drejtat e fëmijëve është ratifikuar nga:

- A) 190 shtete;
- B) 191 shtete;
- C) 194 shtete;
- D) 90 shtete.

Pyetja 130

Deklarata Universale e të drejtave të njeriut u shpall nga Kombet e Bashkuara më:

- A) 1945;
- B) 1948;
- C) 1950;
- D) 1960.

Pyetja 131

Pakti Ndërkombëtar i të Drejtave Ekonomike, Sociale dhe Kulturore është shpallur:

- A) 1966;
- B) 1960;
- C) 1945;
- D) 1948.

Pyetja 132

Pakti Ndërkombëtar i të Drejtave Civile dhe Politike është krijuar më:

- A) 1950;
- B) 1955;
- C) 1966;
- D) 1960.

Pyetja 133

Karta e Kombeve të Bashkuara në vitin 1945 është miratuar nga:

- A) 45 shtete;
- B) 50 shtete;
- C) 54 shtete;
- D) 56 shtete.

Pyetja 134 Magna Karta në Angli u hartua më:

- A) 1210;
- B) 1215;
- C) 1250;
- D) 19270.

Pyetja 135

Deklarata Amerikane e Pavarësisë është hartuar më:

- A) 1770;
- B) 1776;
- C) 1778;
- D) 1790.

Pyetja 136

Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut ndodhet në :

- A) Londër;
- B) Vjenë;

- C) Paris,
- D) Strasburg

Pyetja 137

Komisioni European i të Drejtave të Njeriut u krijua në:

A)

- Uashington;
- B) Paris;
- C) Strasburg;
- D) Moskë.

Pyetja 138

Konventa Amerikane për të Drejtat e Njeriut u miratua më:

- A) 1969;
- B) 1980;
- C) 1985;
- D) 1999.

Pyetja 139

Karta Afrikane për të Drejtat e Njeriut u miratua më:

- A) 1972;
- B) 1980;
- C) 1981;
- D) 1987.

Pyetja 140

Deklarata për një mjedis dhe zhvillim e Rio de Zhanejro është miratuar më :

- A) 1992;
- B) 1995;
- C) 2001;
- D) 2005.

Pyetja 141

Deklarata e Konferencës së Kombeve të Bashkuara të Mjedisit të Njeriut e Stokholm është miratuar më :

- A) 1980;
- B) 1985;
- C) 1972;
- D) 1975.

Pyetja 142

Konferenca Botërore për të Drejtat e Njeriut e vitit 1993 është zhvilluar në:

- A) Vjenë;
- B) Romë;
- C) Madrid;
- D) Athinë.

Pyetja 143

Gjirokastra është pranuar në UNESCO më:

- A) 2005;
- B) 2007;
- C) 2003;
- D) 1999.

Pyetja 144

Një ndër hapat nga Deklarata tek Konventa është:

- A) Nënshkrimi nga shtetet anëtare;
- B) Deklamimi;
- C) Vetëveprimi;
- D) Të tria së bashku.

Pyetja 145

Një nga tiparet e Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut është:

- A) Universale;
- B) E detyrueshme;
- C) Vetëveprimi;
- D) Të tria së bashku.

Pyetja 146

Një nga tiparet e Konventës të të Drejtave të Fëmijve , pasi ka hyrë në fuqi është:

- A) Fakultative;
- B) E detyrueshme;
- C) Vetëveprimi;
- D) Të tria së bashku.

Pyetja 147

Karta Sociale Europiane është mekanizëm i:

- A) Këshillit të Europës;
- B) O K B-së;
- C) O S B E-së;
- D) Të tria së bashku.

Pyetja 148

Këshilli i Europës u themelua më:

- A) 1939;
- B) 1949;
- C) 1945;
- D) 1950.

Pyetja 149

Komiteti i Ministrave të Këshillit të Europës është organ :

- A) Fakultativ;
- B) Vendimmarës;
- C) Konsultativ;
- D) Të tria së bashku.

Pyetja 150

Aktet Normative të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë janë të detyrueshme:

- A) Për gjithë territorin;
- B) Për një pjesë të territorit;
- C) Vetëm për Minoritetet;
- D) Për zonat të vecanta.

Pyetja 151

Ombusmani është organ që zgjidhet nga:

- A) Këshilli i Ministrave;
- B) Ministri i Drejtësisë;
- C) Kuvendi i Shqipërisë;
- D) Dhoma e Avokatisë;

Pyetja 152

Këshilli Bashkiak është organ:

- A) I emëruar;
- B) I zgjedhur i nivelit të parë;
- C) I zgjedhur i nivelit të dytë;
- D) I përzgjedhur i nivelit të dytë.

Pyetja 153

Këshilli i Qarkut është organ:

- A) I emëruar;
- B) I zgjedhur i nivelit të parë;
- C) I zgjedhur i nivelit të dytë;
- D) I përzgjedhur i nivelit të dytë.

Pyetja 154

Qendra Shqiptare e të Drejtave të Njeriut është rregjistruar si fondacion i pavarur më:

- A) 1990;
- B) 1992;
- C) 1994;
- D) 1996.

Pyetja 155

Revista e Qendrës Shqiptare të të Drejtave të Njeriut festoi 10 vjetorin më:

- A) 1990;
- B) 1992;
- C) 1994;
- D) 2004.

Pyetja 156

Dita e Refugjatëve është më:

- A) 8 Mars;
- B) 28 Nëntor;
- C) 20 Qershor;
- D) 5 Korrik.

Pyetja 157

Dita e Botërore e Televizionit është:

- A) 7 Mars;
- B) 21 Nëntor;
- C) 20 Qershor;
- D) 10 Korrik.

Pyetja 158

Deklarata e Kombeve të Bashkuara u firmos më:

- A) 28 tetor 1945;

- B) 24 tetor 1945;
- C) Qershor 1946;
- D) Korrik 1947.

Pyetja 159

Karta e Kombeve të Bashkuara u firmos më:

- A) 28 tetor 1945;
- B) 24 tetor 1945;
- C) Qershor 1948;
- D) Korrik 1949.

Pyetja 160

Pikë kontakti e Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Europën është:

- A) Gjeneva;
- B) Parisi;
- C) Londra;
- D) Madridi.

Pyetja 161

Komisioni mbi Statusin e Grave e ka qendrën në:

- A) Gjenevë;
- B) Vjenë;
- C) Londër;
- D) Nju Jork.

Pyetja 162

Deklarata e të Drejtave të Njerit dhe qytetarit u shpallë në:

- A) SHBA, më 1776;
- B) Francë, më 1789;
- C) Angli, më 1832;
- D) Gjermani, më 1870.

PYETJET PËR HISTORINË E KOMBIT SHQIPTAR

A. HISTORI

I. LASHTËSIA

Pyetja 1

Kur janë shfaqur qeniet e vërteta njerëzore:

- A) Rreth 500.000 vjet më parë
- B) Rreth 400.000 vjet më parë
- C) Rreth 250.000 vjet më parë
- D) Rreth 100.000 vjet më parë

Pyetja 2

Çfarë ishte kopeja primitive:

- A) Një bashkim i njerëzve primitivë mbi bazë të lidhjeve të gjakut
- B) Një bashkim i njerëzve primitivë mbi bazën të lidhjeve territoriale
- C) Një bashkim i paramenduar i njerëzve primitivë
- D) Një bashkim i vetvetishëm i njerëzve primitivë

Pyetja 3

Arritja e parë e madhe që tregon epërsinë e njeriut ndaj kafshëve ishte:

- A) Krijimi i familjes
- B) Ndërtimi i banesave
- C) Përdorimi i zjarrit
- D) Punimi e mbjellja e tokës

Pyetja 4

Monumentet më të vjetra të kulturës njerëzore janë:

- A) Mitet dhe legjendat
- B) Vizatimet e para në muret e shpellave
- C) Skulptura prej kocke e gur

D) Veglat e punës

Pyetja 5

Aktiviteti i parë për sigurimin e ushqimit tek njerëzit primitivë ishte:

- A) Bujqësia
- B) Blegtoria
- C) Bujqësia dhe blegtoria, njëkohësisht
- D) Gjuetia dhe mbledhja e produkteve të gatshme nga natyra.

Pyetja 6

Karakteristika për njerëzit primitivë ishte:

- A) Mungesa e veshjes
- B) Mungesa e vendbanimeve
- C) Mungesa e familjes
- D) Mungesa e të gjithave bashkë

Pyetja 7

Gjinia ishte:

- A) Grupi i njerëzve që kishin një vendbanim të përbashkët
- B) Grupi i njerëzve që kishin zakone të njëjta
- C) Një grup i qëndrueshëm njerëzish me orgjinë dhe lidhje gjaku të përbashkët
- D) Grupi i njerëzve që jetonin e punonin së bashku

Pyetja 8

Në krye të gjinisë ishin:

- A) Kryepleqtë e zgjedhur nga anëtarët
- B) Burrat më të moshuar e më të mençur
- C) Burrat më të fortë fizikisht
- D) Gratë më të mëshuara e më të mençura

Pyetja 9

Cilët nga faktorët ndikuan në lindjen e bujqësisë:

- A) Jetesa e njerëzve në vendet të përhershme
- B) Pasiguria e pamjaftueshme për plotësimin e nevojave me ushqim
- C) Garancia e bollëkut në sigurimin e ushqimit
- D) Të tria së bashku

Pyetja 10

Fillimi i praktikimit të ndarjes së punës në epokën e neolitit i kushtëzuan nga:

- A) Tradita e trashëgimisë familjare
- B) Arritja e sigurimit të ushqimit bujqësor vetëm nga një pjesë e banorëve
- C) Kriteri gjinor
- D) Mungesa e të gjithave bashkë.

II. LINDJA E MESME E LASHTË

Pyetja 11

Fillimi i qytetërimit në luginën e lumit Nil dhe në Mesopotami ishte rezultat:

- A) I organizimit shoqëror dhe politik shumë të fortë
- B) I ekzistencës së një feje kolektive të lidhur ngushtë me pushtetin
- C) I pjellorisë të lartë të tokës
- D) Të tria bashkë

Pyetja 12

Cilët nga fiset e mëposhtme nomade u dyndën në Mesopotaminë e jugut rreth vitit 3200 p.l.k:

- A) Amorjetë
- B) Gutët
- C) Hyksosë

D) Sumerianët

Pyetja 13

Banorët e Mesopotamisë u dalluan:

- A) Në punimin e qeramikës
- B) Për teknikë të lartë të punimit të metaleve
- C) Në fushën e bujqësisë e në ndërtimin e veprave ujitëse e kulluese
- D) Të tria bashkë

Pyetja 14

Shkrimi kuneiform u përdor nga:

- A) Babilonasit
- B) Fenikasit
- C) Egjiptianët
- D) Indianët

Pyetja 15

Harta më e vjetër është përpiluar rreth viteve 2500 p.l.k. nga:

- A) Kinezët
- B) Babilonasit
- C) Egjiptianët
- D) Grekët

Pyetja 16

Vepra letrare "Epi i Gilgameshit" është shkruar nga:

- A) Kinezët
- B) Persianët
- C) Babilonasit
- D) Hebrenjtë

Pyetja 17

Cilat qenë arritjet e banorëve të Mesopotamisë në fushën e matematikës e të gjeometrisë:

- A) Njohja e së ashtuquajturës "Teorema e Pitagorës" disa shekuj para Pitagorës
- B) Llogaritja e rrënjës katrore dhe ndarja e rrethit në 360°
- C) Zgjidhnin problema me ekuacione të gradës së dytë dhe të tretë dhe përdorimin ngjashmërinë e figurave
- D) Të tria bashkë

Pyetja 18

Cilat qenë arritjet e babilonasve në fushën e astronomisë:

- A) Grumbullimin e të dhënave për yjet, kometat, njollat diellore; hartuan harta të yjeve
- B) Njohja e 5 planetëve më afër diellit dhe llogaritja e eklipsit të hënës
- C) Hartimi i kalendarit diellor me 365 ditë
- D) Të tria bashkë

Pyetja 19

Sunduesi i babilonasve, Hamurabit e bashkoi Mesopotaminë:

- A) Me mbështetjen e mirëkuptimin e sunduesve krahinorë
- B) Me ndihmën e shteteve fqinje
- C) Nëpërmjet luftërave
- D) Të tria bashkë

Pyetja 20

Kodi i Hamurabit synonte:

- A) Përcaktimin e detyrimeve të shtetasve
- B) Vendosjen e marrëdhënieve me shtetasit
- C) Forcimin e shtetit
- D) Të tria bashkë

Pyetja 21

Çfarë sanksiononte Kodi i Hamurabit:

- A) Mbrojtjen e interesave të skllavopronarëve, pronarëve të tokave, priftërinjve, tregtarëve e fajdexhinjve
- B) Zgjedhjen e qytetarëve në postet shtetërore me short
- C) Barazinë e shtetasve para ligjit
- D) Të tria bashkë

Pyetja 22

Pse thuhej se Egjipti ishte "dhuratë e Nilit":

- A) Për prurjen e madhe ujore dhe vërshimeve me cikle të rregullta
- B) Për mundësitë që ofronte lumi për zhvillimin e bujqësisë, si rezultat i pjellorisë të lartë të tokës
- C) Për shfrytëzimin e lumit si një rrugë e përshtatshme për transport
- D) Të tria bashkë

Pyetja 23

Kryeqytet i mbretërisë së vjetër egjiptiane ishte:

- A) Asuri
- B) Memfisi
- C) Uruka
- D) Teba

Pyetja 24

Si quheshin sundimtarët në Egjipt

- A) Faraonë
- B) Basileum
- C) Raxha
- D) Car

Pyetja 25

Ç'përfaqësonte pushtetin e faraonit:

- A) Ishte përfaqësues më i lartë i klerit
- B) Ishte gjykatës suprem
- C) Ishte komandant i ushtrisë
- D) Të tria bashkë

Pyetja 26

Cili ishte shkaku i ndërtimit të piramidave në Egjipt:

- A) Funkciononin si pika vrojtimi
- B) Funkciononin si qendra kulturore
- C) Shërbenin për të vendosur trupin e faraonit pasi vdiste
- D) Të tria bashkë

Pyetja 27

Faraoni në Egjipt mbretëronte:

- A) Në emër të ligjit
- B) Si përfaqësues i popullit
- C) Në emër të perëndive
- D) Të tria bashkë

Pyetja 28

Cilët faktorë ndikuan në rënien e Mbretërisë së Vjetër Egjiptiane:

- A) Dyndjet e popujve nomadë
- B) Sulmet nga vendet e tjera
- C) Konfliktet e brendshme
- D) Të tria bashkë

Pyetja 29

Kryeqytet i Mbretërisë së Mesme Egjiptiane ishte:

- A) Akadi
- B) Teba
- C) Uri
- D) Asuri

Pyetja 30

Mbretëria e Re Egjiptiane zgjati:

- A) Nga viti 2000 p.K. deri në vitin 1800 p.K.
- B) Nga viti 1800 p.K. deri në vitin 1100 p.K.
- C) Nga viti 1600 p.K. deri në vitin 1100 p.K.
- D) Nga viti 1100 p.K. deri në vitin 525 p.K.

Pyetja 31

Kur u rrëzua dinastia e fundit egjiptiane:

- A) Në vitin 670 p.K., me pushtimin asirian
- B) Në vitin 525 p.K., me pushtimin persian
- C) Në vitin 670 p.K., nga Aleksandri i Madh
- D) Nga fund të shek. I p.K., me pushtimin romak

Pyetja 32

Cila ishte pozita e gruas në qytetërimin egjiptian:

- A) Kishte të drejtën e trashëgimisë
- B) Kishte të drejtë e shitjes e të blerjes së pasurisë
- C) Ishte e detyruar t'i bindej babait dhe burrin të saj
- D) Të tria bashkë

Pyetja 33

Budizmi lindi në:

- A) Asiri
- B) Egjipt
- C) Indi
- D) Persi

Pyetja 34

Si quhej mbreti në Indi:

- A) Faraon
- B) Basileum
- C) Car
- D) Raxha

Pyetja 35

Nismëtar i besimit budist ishte:

- A) Moisiu
- B) Asoka
- C) Zoroastro
- D) Siddhartha Gautama

Pyetja 36

Idetë e tij, Buda i paraqiti:

- A) Në "Librin e zbulesës
- B) Në ediktet e Asokës
- C) Nëpërmjet "katër të vërtetave fisnike"
- D) Si rregulla morale në trajtën e ligjeve, të cilat u bënë të njohura si "Dhjetë porositë"

Pyetja 37

Ndarja e shoqërisë indiane në kasta:

- A) Nuk lejohej kalimin nga njëra kastë tek tjetra
- B) Ndalohej kalimi nga njëra kastë tek tjetra
- C) Ishte e ngurtë
- D) Të tria bashkë

Pyetja 38

Sipas predikimeve të Budës, shkaktar i të këqijave ishte:

- A) Dëshira dhe përpjekjet e njerëzimit që të donin e admironin vendin e tyre
- B) Mjedisi gjeografik
- C) Qeverisjes së keqe
- D) Të tria bashkë

Pyetja 39

Qëllimi i misionarëve budistë ishte:

- A) Të edukonin njerëzimit që të donin e admironin vendin e tyre
- B) Të kthenin sa më shumë indianë në budistë
- C) Ndërtimi i manastireve
- D) Të tria bashkë

Pyetja 40

Çfarë predikonte filozofia taoiste:

- A) Besnikëri ndaj traditës dhe respektim të paraardhësve
- B) Barazi, drejtësi dhe lumturi për të gjitha qeniet mbi tokë
- C) Zbulimin e rrugës së universit dhe të jetuarit thjesht e në harmoni me natyrën
- D) Të tria bashkë

Pyetja 41

Cilat ide filozofike udhëhoqën qeverisjen dhe jetën shpirtërore të Kinës gjatë shek. III p.K.:

- A) Filozofia e legalizmit
- B) Idetë filozofike të Konfucit
- C) Taoizmi
- D) Të tria bashkë

Pyetja 42

Çfarë predikonte filozofia e Konfucit:

- A) Zbulimin e rrugës së universit dhe të jetuarit thjeshtë e në harmoni me natyrën
- B) Njerëzit janë qenie që kanë nevojë për një drejtim autoritar
- C) Besnikërinë ndaj traditës dhe respektimin e paraardhësve
- D) Domosdoshmërinë për ndryshime rrënjësore në jetën shoqërore

Pyetja 43

Muri i Madh në Kinë u ndërtua në periudhën e sundimit të dinastisë:

- A) Sine
- B) Han
- C) Dxon
- D) Çin

Pyetja 44

Si përzgjidheshin personat që kërkonin punë në administratën shtetërore në periudhën e sundimit të dinastisë Han:

- A) Me konkurs ku provoheshin njohuritë e tyre në provim me shkrim
- B) Nga prejardhja fisnike
- C) Të ishin në moshë mbi 40 vjeç
- D) Të ishin shumë të pasur

Pyetja 45

Përse dinastitë kineze kishin një zhvillim ciklik:

- A) Për shkak të vështirësive ekonomike, të pakënaqësi së popullit dhe të këmbënguljes së fisnikëve për të marrë pjesë në pushtet
- B) Se ndërpritej vazhdimësia e zhvillimit për shkak se vinin në fuqi sundimtarët gjithnjë e më pak të aftë sesa themeluesi i parë dinastisë si dhe nga korrupsioni i lartë i zyrtarëve të oborrit e shpërdorimi i të hollave
- C) Për shkak të rigjallërimit dhe rizhvillimit të vendit me fillimin e qeverisjes së dinastisë së re
- D) Të tria bashkë

Pyetja 46

Ku është prodhuar për herë të parë instrumenti i regjistrimit të tërmeteve në:

- A) Indi
- B) Babiloni
- C) Kinë
- D) Greqi

Pyetja 47

Busulla magnetike është shpikur nga:

- A) Grekët
- B) Kinezët
- C) Romakët
- D) Arabët

Pyetja 48

Cilët kanë shpikur e prodhuar të parët letrën:

- A) Indianët
- B) Egjiptianët
- C) Kinezët
- D) Fenikasit

III. GREQIA E LASHTË

Pyetja 49

Grupet kryesore fisnore të popullit të vjetër grek në mijëvjeçarin e parë p.l.k ishin:

- A) Akejasit
- B) Dorët
- C) Jonët
- D) Të tria grupet së bashku

Pyetja 50

Në historinë e Greqisë së lashtë, shekujt XII-VIII p.K., përfshijnë:

- A) Kulturën e Kretës
- B) Kulturën e Mikenës
- C) Periudhën homerike
- D) Lindjen e qyteteve-shtete

Pyetja 51

Shoqëria greke e periudhës homerike ishte:

- A) Primitive
- B) Kalimtare (në shtur e sipër të rendit gjinor)
- C) Tipike skllavopronare
- D) Skllavopronare në shturje

Pyetja 52

Burimi kryesor i skllavërisë në Greqi në periudhën homerike ishte:

- A) Mosshlyerja e borxheve
- B) Blerja e skllavëve
- C) Lufta dhe grabitjet
- D) Të tria bashkë

Pyetja 53

Për studimin e historisë të Greqisë, në shekujt XII-VIII p.l.k., si burim kryesor shërbejnë:

- A) Burimet arkivore
- B) Poemat homerike "Iliada" dhe "Odisea"
- C) Të dhënat zyrtare
- D) Të tria bashkë

Pyetja 54

Si masë vlere në periudhën homerike në Greqi përdorej:

- A) Monedha prej bronxi
- B) Monedha prej ari
- C) Dhrahmija
- D) Gjëja e gjallë

Pyetja 55

Cilët nga organet drejtuese të poshtëshënuara i përket Greqisë së periudhës Homerike:

- A) Mbreti
- B) Këshilli i pleqve
- C) Mbledhja popullore
- D) Të tria bashkë

Pyetja 56

Në periudhën homerike në Greqi, basileu kryente funksionet:

- A) E gjykatësit
- B) Të komandantit ushtarak në kohë lufte
- C) Të priftit
- D) Të tria bashkë

Pyetja 57

Qytet-shtet në Greqi (poliset) lindën në periudhën:

- A) 2100-1700 p.K.
- B) 1700-1100 p.K.
- C) 1100-700 p.K.
- D) 700-600 p.K.

Pyetja 58

Cilat qenë shkaqet e krijimit të ngulimeve greke jashtë territorit të Greqisë:

- A) Konfliktet fetare
- B) Fushatat ushtarake
- C) Faktorët ekonomike e politikë
- D) Të tria bashkë

Pyetja 59

Ngulimet greke jashtë territorit të Greqisë së Vjetër:

- A) Nuk luajtën asnjë rol në zhvillimin e brendshëm të vendit
- B) Nuk ndikuan në marrëdhëniet e Greqisë me vendet e tjera
- C) Ngadalësuan ritmet e zhvillimit ekonomiko-shoqërore të Greqisë
- D) Shpejtuan ritmet e përparimit të vendit

Pyetja 60

Kolonizimi grek në shekujt VIII-VI p.K. u shoqërua:

- A) Me ngadalësimin e zhvillimit të Greqisë së Vjetër
- B) Me zhvillimin e tregtisë dhe përvetësimin e ndërsjellët kulturor
- C) Me asimilimin e popullsisë të atyre vendeve ku u vendosën
- D) Me konflikte të armatosura

Pyetja 61

Në Iliri grekët krijuan koloni vetëm në:

- A) Dyrrah
- B) Oriku
- C) Apoloni
- D) Në të tre qytetet e lartpërmendura

Pyetja 62

Formimi i shtetit të Athinës përfundoi:

- A) Në shekullin XII p.K.
- B) Në shekullin VIII p.K.
- C) Në shekullin VII p.K.
- D) Në shekullin V p.K.

Pyetja 63

Ligjet e Drakonit sanksiononin:

- A) Liritë e të drejtat e skllëvërve
- B) Mbrojtjen e pronës private
- C) Barazinë e burrit me gruan
- D) Asnjëra nga këto shtresa

Pyetja 64

Në shtetin e Athinës Aeropagu ishte një institucion:

- A) Administrativ.
- B) Ekonomik
- C) Ushtarak
- D) Gjyqësor

Pyetja 65

Në Athinën e vjetër arkondët zgjidheshin nga:

- A) Fshatarët
- B) Zejtarët
- C) Aristokracia
- D) Nga të tria këto grupe shoqërore së bashku

Pyetja 66

Cilët nga organet e mëposhtme u krijua nga Soloni:

- A) Aeropagu
- B) Jeliëja
- C) Këshilli i të Pesëqindëve.
- D) Kuvendi Popullor

Pyetja 67

Cilat nga burimet e sigurimit të sklevërve në Athinën e vjetër :

- A) Lindja nga prindërit sklevër
- B) Blerja e tyre jashtë shtetit
- C) Robërit e luftës
- D) Të tria mënyrat njëherësh

Pyetja 68

Kolegji i Dhjetë Strategëve në shtetin e Athinës ishte organ përgjegjës:

- A) Fuqiptotë në situata të jashtëzakonshme për të zgjidhur të gjitha çështjet e shtetit
- B) Për organizimin e drejtimin e ushtrisë
- C) Për mbrojtjen e kufijve të Atikës dhe ndërtimin e anijeve të luftës

D) Për të tria njëkohësisht

Pyetja 69

Këshilli i Dhjetë Strategëve në Athinë zgjidhej:

- A) Me short
- B) Me votim të hapur
- C) Me votim të fshehtë
- D) Nëuk zgjidhej, por emërohej nga Kuvendi i të Pesëqindëve

Pyetja 70

Si zgjidheshin anëtarët e Gjyqit të Jurisë (Jelieja) në Kohën e Perikliut në Athinë:

- A) Me votim të hapur
- B) Me votim të fshehtë
- C) Me short
- D) Me konkurs, duke provuar njohuritë e tyre në provimin me shkrim

Pyetja 71

Roli kryesor i qeverisjes në kohën e Perikliut në shtetin e Athinës takonte:

- A) Kuvendit të të Pesëqindëve
- B) Kuvendit të Qytetarëve
- C) Këshillit të Dhjetë Strategëve
- D) Gjyqit të Jurisë

Pyetja 72

Reforma për zgjedhjen e qytetarëve të Athinës në postet shtetërore me short u bë nga:

- A) Klistheni
- B) Perikliut
- C) Pisistrati
- D) Soloni

Pyetja 73

Luftërat greko-persiane filluan në vitin:

- A) 513 p.K.
- B) 500 p.K.
- C) 492 p.K.
- D) 490 p.K.

Pyetja 74

Për herë të parë në Evropë persianët depërtuan në vitin:

- A) 513 p.K.
- B) 500 p.K.
- C) 491 p.K.
- D) 480 p.K.

Pyetja 75

Cilat qenë shkaqet e shpërthimit të luftërave greko-persiane:

- B) Në fillim të shek. IX
- C) Nga mesi i shek. XI
- D) Nga fundi i shek. XII

Pyetja 278

Në ringjalljen e qyteteve mesjetare ndikuan:

- A) Sulmet barbare
- B) Konfliktet e vazhdueshme të feudalëve me pushtetin mbretëror
- C) Ndryshimet thelbësore në fushën e ekonomisë e tregtisë
- D) Të tria bashkë

Pyetja 279

Si ndikuan shndërrimet e mëdha që ndodhën në bujqësinë evropiane në fillimet e shek. XI, në gjendjen e bujkrobërve:

- A) Heqjen përfundimisht të bujkrobërisë
- B) Faljen e taksave
- C) Lordëve u premtuan më shumë liri dhe pagimin e një takse të caktuar në vend të angarisë
- D) Të tria bashkë

Pyetja 280

Çfarë zhvillimesh solli rritja e prodhimeve bujqësore në shek. XI-XII, për popullsinë:

- A) Rritjen e numrit të popullsisë
- B) Përmirësimin e kushteve të jetesës dhe pakësimin e vdekjeve nga uria
- C) Shkëputjen e një pjese të popullsisë nga fshati e bujqësia, të cilët u vendosën në qytetet e reja ose ato të vjetra, ku mund të merreshin me zejtari, tregti etj
- D) Të tria bashkë

Pyetja 281

Ç'pasoja pati ngritja e disa qyteteve mesjetare në tokat e lordëve:

- A) Iu nënshtruan plotësisht pushtetit të feudalëve
- B) Orientimi ekonomik i tyre ishte vetëm agrar
- C) Mbështetën feudalët në luftë kundër pushtetit mbretëror
- D) Hynë në konflikt me feudalët për të fituar disa të drejta

Pyetja 282

Si e fituan lirinë qytet mesjetare:

- A) Me dekret mbretëror
- B) Me ndërmjetësimin e kishës
- C) Herë me luftë dhe herë me anë të të hollave që u jepnin feudalëve

D) Të tria bashkë

Pyetja 283

Cilat qenë parimet kryesore mbi të cilat vepronin shoqatat prodhuese në Mesjetë:

- A) Nuk lejonin konkurrimin e lirë midis anëtarëve të shoqatës
- B) Nuk lejohej konkurrimi i lirë dhe kishte rregulla të ngurta për sasinë, cilësinë e çmimin e prodhimeve
- C) E drejta e mallrave të prodhuara sipas dëshirës së prodhuesve
- D) E drejta e anëtarëve të shoqatës për të prodhuar mallra sipas dëshirës së tyre

Pyetja 284

Pse u fuqizua autoriteti i kishës në periudhën e Mesjetës:

- A) Kryente veprimtari bamirësie në dobi të njerëzve
- B) Frenoi përhapjen e dhunës duke predikuar mirëkuptimin dhe vëllazërimin midis njerëzve
- C) Vendosi sundimin absolut shpirtëror dhe cilësohej si i vetmi autoritet që rridhte nga vetë zoti
- D) Të tria bashkë

Pyetja 285

Cilat ishin privilegjet e kishës në periudhën e Mesjetës:

- A) Merrte nga të gjithë besimtarët 1/3 e prodhimit të njohur me emrin "e treta e kishës"
- B) Nuk paguante taksa
- C) Gëzonte pavarësi të plotë nga pushteti laik
- D) Të tria bashkë

Pyetja 286

Kritikat ndaj kishës në fillim të shek. XI, synonin:

- A) Ta largonin kishën dhe klerikët nga korrupsioni dhe shthurja morale
- B) Reformimin e kishës
- C) Pavarësinë e kishës nga pushteti laik
- D) Të tria bashkë

Pyetja 287

Kush e shpalli dekretin që ndalonte ndërhyrjen e pushtetit perandorak në zgjedhjen e ipeshkëve:

- A) Papa Leo III, në vitin 1800
- B) Papa Grogori VII, në vitin 1075
- C) Papa Urbani II, në vitin 1097
- D) Papa Inoçenti III, në vitin 1216

Pyetja 288

Në Mesjetë pushteti i papës ishte i padiskutueshëm:

- A) Sundimtarët
- B) Njerëzit e thjeshtë
- C) Klerikët
- D) Të gjithë bashkë

Pyetja 289

Ç'kontribut dha papa Inoçenti III për forcimin e rolit të kishës:

- A) Lejoi shitjen e posteve fetare
- B) Lejoi martesën e priftërinjve
- C) Fuqizoi parimin se papa, si autoriteti më iu lartë dhe mëkëmbësi i zotit në tokë, mund të ndërhynte dhe të vendoste për gjithçka
- D) Të gjithë bashkë

Pyetja 290

Çfarë kërkonte urdhëri françeskan:

- A) Unifikimin e kishës Perëndimore katolike me kishën Lindore ortodokse
- B) Një kishë të shkëputur nga pushtetin politik
- C) Të rizbulonin vlerat e kristianizmit, si: dashuria për njerëzit, bukuria e natyrës e dhënë nga Zoti, dhe vlerat e të jetuarit në varfëri

D) Të tria bashkë

Pyetja 291

Çfarë kërkonte urdhëri domenikan:

- A) Luftë kundër të pasurve dhe pabarazisë shoqërore
- B) Pastërtinë teologjike të kishës, duke iu përkushtuar kulturës, arsimit dhe predikimit në universitete
- C) Një kishë pa lidhje me pushtetin politik
- D) Të gjitha bashkë

Pyetja 292

Fushatat kryqtare gjatë Mesjetës, u organizuan dhe u drejtuan nga:

- A) Kisha ortodokse
- B) Kisha katolike
- C) Perandoria Gjermane
- D) Të tria bashkë

Pyetja 293

Fushatat kryqtare gjatë Mesjetës, u ndërmorën për shkaqe:

- A) Fetare
- B) Politike
- C) Tregtare
- D) Të tria bashkë

Pyetja 294

Kush morri pjesë fushatat e kryqëzatave:

- A) Fshatarët e mesëm dhe e të varfër dhe popullsia qytetare
- E) Feudalët, kalorësit, zejtarët dhe tregtarët
- F) Të pakënaqurit, ambiciozët dhe bujkrobërit
- E) Të gjitha bashkë

Pyetja 295

Pse kisha arriti të sigurojë një pjesëmarrje të madhe të njerëzve në fushatat kryqtare:

- A) Pushtimi i Jerusalemit më 1097 nga turqit selxhuk u bë shtysë për kishën katolike, e cila u bëri thirrje besimtarëve të saj për të çliruar varrin e Krishtit nga myslimanët
- B) Të përhapnin besimin kristalin në vendet e Lindjes
- C) Njerëzit u nxitën nga predikimet e kishës për "shpëtimin e përhershëm" dhe për "pasuritë përrallore" të Lindjes
- D) Për të gjitha bashkë

Pyetja 296

Kur filloi Kryqëzata e Parë:

- A) Në vitin 1075
- B) Në vitin 1097
- C) Në vitin 1144
- D) Në vitin 1189

Pyetja 297

Kryqëzata e Parë pushtoi:

- A) Kostandinopojën
- B) Egjiptin
- C) Jerusalemin
- D) Gadishullin e Ballkanit

Pyetja 298

Kur filloi Kryqëzata e Dytë:

- A) Në vitin 1097
- B) Në vitin 1147
- C) Në vitin 1189
- D) Në vitin 1202

Pyetja 299

Shkak për organizimin e Kryqëzata së Dytë u bë rimarrja e:

- A) Edesës, nga myslimanët
- B) Jerusalemit, nga turqit
- C) Sirisë, nga turqit
- D) Të tria bashkë

Pyetja 300

Kur u zhvillua Kryqëzata e Tretë:

- A) Në vitet 1097-1099
- B) Në vitet 1147-1149
- C) Në vitet 1189-1192
- D) Në vitet 1202-1204

Pyetja 301

Si përfundoi Kryqëzata e Tretë:

- A) Me rimarrjen e Jerusalemit nga kryqtarët, më 1189
- B) Me pushtimin e Mekës, më 1190
- C) Me pushtimin e Kostandinopojës, më 1192
- D) Me dështimin e plotë

Pyetja 302

Në vitin 1204, Perandoria Bizantine u pushtua nga:

- A) Mongolët
- B) Turqit selxhuk
- C) Bullgaria
- D) Kryqëzata e Katërt

Pyetja 303

Dështimi i kryqëzatave çoi në:

- A) Në fuqizimin e fisnikëve evropianë
- B) Dobësimin e pushtetit të mbretërve evropianë
- C) Rënien e autoritetit të pushtetit të papatit
- D) Të tria bashkë

Pyetja 304

Cilat qenë format e shkollimit në mesjetë:

- A) Shkollat e ulëta
- B) Shkollat me karakter të mesëm
- C) Shkollat e lartë (studio generale)
- D) Të tria bashkë

Pyetja 305

Universiteti më i vjetër në Evropë është:

- A) Universiteti i Pragës
- B) Universiteti i Parisit
- C) Universiteti i Napolit
- D) Universiteti i Oksfordit

Pyetja 306

Në ç'gjuhë zhvilloheshin mësimet në universitetet mesjetare:

- A) Në gjuhën frëngjisht
- B) Në gjuhën latinisht
- C) Në gjuhën angleze
- D) Në gjuhën greke

Pyetja 307

Kush e ka shpikur shtypshkronjën:

- A) Thoma Akuini (1245-1274)
- B) Filip Brunolesku (1377-1446)
- C) Johan Gutenbergu (1397-1468)
- D) Leon Batista (1401-1472)

Pyetja 308

Eposi "Sidi" u krijua në:

- A) Angli
- B) Francë
- C) Itali
- D) Spanjë

Pyetja 309

" Këngët e Rolandit" u krijua në:

- A) Angli
- B) Francë
- C) Itali
- D) Gjermani

Pyetja 310

Ç'kontribut dha Roxher Bekoni (1214-1292) për studimin e natyrës:

- A) Korrigjoi shumë teori të gabuara të mendimtarëve të lashtë grekë për natyrën
- B) Ishte ndër të parët në Evropë që hodhi idenë për domosdoshmërinë e studimit eksperimental të natyrës

- C) Shkroi veprën "Enciklopedia e botëkuptimit mesjetar"
- D) Të gjitha bashkë

Pyetja 311

Kur lindi kultura humaniste evropiane:

- A) Në Francë
- B) Në Angli
- C) Në Rusi
- D) Në Itali

Pyetja 312

Eposi "Sidi" u krijua në:

- A) Angli
 - B) Francë
 - C) Itali
 - D) Spanjë
-

B. HISTORIA E KOMBIT SHQIPTAR

Pyetja 313

Elementët e parë të shtetit në Iliri, u shfaqen në:

- A) Epokën e bronzit
- B) Fiset patriakale

- C) Federatat fisnore
- D) Bashkësitë fisnore

Pyetja 314

Shteti Ilir, në kohën e krijimit të tij, kishte si kufij verior-jugor:

- A) Naronë-Ambakri
- B) Vjosë-Ambakri
- C) Sava-Ambakri
- D) Naronë-Vjosë

Pyetja 315

Shteti i Epirit, në kohën e krijimit të tij, kishte si kufij verior-jugor:

- A) Naronë-Vjosë
- B) Vjosë-Ambakri
- C) Naronë-Ambakri
- D) Sava-Ambakri

Pyetja 316

Peshën kryesore në luftën e Peloponezitetit e mbajtën:

- A) Taulanët
- B) Dardanët
- C) Enkelejtit
- D) Ardianët

Pyetja 317

Në trevën e liqenit Lychnid, banonin:

- A) Dardanët
- B) Enkelejtit
- C) Pajonët
- D) Taulanët

Pyetja 318

Lufta e Peloponoezit u zhvillua në vitet:

- A) 520 - 423 p.K.
- B) 431 - 411 p.K.
- C) 393 - 350 p.K.
- D) 421 - 411 p.K.

Pyetja 319

Pleurati, ishte përfaqësues i:

- A) Mbretërisë së taulantëve
- B) Enkelease
- C) Dardane
- D) Ardiane

Pyetja 320

Viti 250 p.K. pas vdekjes së Pleuratit, shënon ardhjen në fron të:

- A) Gentit
- B) Teutës
- C) Glaukisë
- D) Agronit

Pyetja 321

Mbreti i parë ilir ishte:

- A) Manuni
- B) Glaukia
- C) Bardhyli
- D) Mytili

Pyetja 322

Disfata në Luftën iliro-romake, u përcaktua nga:

- A) Veprimet e dobëta luftarake
- B) Dobësitë e brendshme
- C) Tradhtia e e Dhimitër Farit
- D) Tradhëtia e aleatëve maqedonas

Pyetja 323

Bërthama e Shtetit të Epirit ishte:

- A) Bashkësia Thesprote;
- B) Bashkësia Molose;
- C) Bashkësia Kaone;
- D) Lidhja Epirote.

Pyetja 324

Fushata Maqedonase, kundër dardanëve u zhvillua:

- A) Në fund të shek. IV p.K.
- B) Në fillim të shek. III p.K.
- C) Nga fundi i shek. III p.K.
- D) Nga fundi i shek. II p.K.

Pyetja 325

Mbretëria Dardane përmendet si formacion shtetëror i spikatur në:

- A) Fund të shek. V p.K.
- B) Fund të shek. IV p.K.
- C) Fillim të shek. III p.K.
- D) Fund të shek. III p.K.

Pyetja 326

Cili prej qyteteve të mëposhtme, u krijua qendër qytetare, gjatë shekujve IX - XI?

- A) Apollonia
- B) Drishti
- C) Lisi
- D) Tivari

Pyetja 327

Në qytetet shqiptare në Mesjetë, organ i rëndësishme i qeverisjes ishte:

- A) Mbledhja e popullit
- B) Këshilli i qytetit
- C) Këshilli i fisnikëve
- D) Konti i qytetit

Pyetja 328

Principata e Arbërit në shek. XII, kishte për qendër:

- A) Durrësin
- B) Shkodrën
- C) Krujën
- D) Lezhën

Pyetja 329

Principata e Arbërit arriti kulmin e fuqizimit të saj, në kohën e sundimit të:

- A) Dhimitrit
- B) Progonit
- C) Gjinit
- D) Grigor Kamonës

Pyetja 330

Cili nga sundimtarët e mëposhtëm ka mbajtur titullin "judex"?

- A) Progoni
- B) Dhimitri
- C) Gjergj Balsha
- D) Teodor Muzaka

Pyetja 331

Banorët e qyteteve, sipas pasurisë ndaheshin në:

- A) Fisnikë dhe zejtarë
- B) Çifligarë dhe parikë
- C) Fisnikë dhe popullorë
- D) Dinatë dhe popullorë

Pyetja 332

Themmat në trevën e Arbërisë ishin:

- A) Krahina autonome
- B) Provinca autonome
- C) Shtete brenda shtetit
- D) Provinca romane

Pyetja 333

Viti 1374 në Principatën e Topiajve, ju kujton:

- A) Betejën e Savës
- B) Betejën pranë Kosturit
- C) Aleancën me Papën
- D) Pushtimin e Ulqinit

Pyetja 334

Papa, i dha titullin "Konti i madh i Arbërit":

- A) Teodor Muzakës
- B) Karl Topisë
- C) Balshës II
- D) Tanush Topisë

Pyetja 335

Titulli "Despot" iu dha nga Perandori i Bizantit:

- A) Teodor Muzakës
- B) Karl Topisë
- C) Balshës II
- D) Tanush Topisë

Pyetja 336

Gjin Bue Shpata, sundonte:

- A) Prej lumit Kallamas deri në Korint
- B) Prej Drinos deri në Akamani
- C) Etoli deri tek Gjiri i Korintit
- D) Akamani deri tek Gjiri i Artës

Pyetja 337

Përfaqësuesi më i shquar i Pashallëkut të Shkodrës ishte

- A) Mehmet Pasha
- B) Mahmut Pasha
- C) Mustafa Pasha
- D) Ibrahim Pasha

Pyetja 338

Gjatë shek. XIII - XV, kultura shqiptare u zhvillua nën ndikimin:

- A) E kulturës romake
- B) E kulturës bizantine
- C) Si një kulturë origjinale shqiptare
- D) Apo asnjëra prej tyre

Pyetja 339

Gjatë shek. XIII - XV, tematika e pikturës është:

- A) Kishtare
- B) Nga jeta e përditshme
- C) Të dyja së bashku
- D) Apo asnjëra prej tyre

Pyetja 340

Pushtimet e para osmane në Shqipëri lidhen me:

- A) Përçarjen e familjeve të mëdha feudale
- B) Mungesën e informacionit
- C) Përçarjen e shteteve të Ballkanit
- D) Epërsinë ekonomike, politike dhe ushtarake të osmanëve

Pyetja 341

Për formimin e shtetit të përqendruar, Skënderbeu u mbështet tek:

- A) Fshatarësia e lirë
- B) Tregtarët e zejtarët
- C) Princërit lokalë
- D) Venediku e Papati

Pyetja 342

Me Kuvendin e Lezhës u arrit:

- A) Krijimi i Shtetit të përqendruar shqiptar
- B) Zgjedhja e Skënderbeut në krye të shtetit
- C) Bashkimi i forcave politike, ekonomike dhe ushtarake të vendit
- D) Forcimi i ushtrisë shqiptare

Pyetja 343

Skënderbeu doli në krye të Lidhjes Shqiptare për:

- A) Pozitën e zotërimeve të Kastriotëve
- B) Aftësitë e tij të veçanta
- C) Lidhjet e shumta farefisnore
- D) Të gjitha së bashku

Pyetja 344

Traktati i paqes me Venedikun u lidh për shkak të forcave të ushtrisë:

- A) Dobësimin të forcave të ushtrisë shqiptare
- B) Marrjes së atributit prej 1400 dukatesh në vit
- C) Tradhtisë së Nikollë Dakugjinit
- D) Lufta në të dy frontet

Pyetja 345

Beteja që vuri në provë "Lidhjen e Princave shqiptarë" me njëherë pas krijimit të saj, ishte:

- A) Beteja e Mokrës
- B) Beteja e Torviolit
- C) Lufta kundër Venedikut

D) Beteja në Fushë-Kosovë

Pyetja 346

Synimet e Venedikut qëndronin, në pushtimin e:

- A) Drishtit dhe Shkodrës
- B) Qytetet bregdetare
- C) Gjirokastrës dhe Kaninës
- D) Ulqinit dhe Tivarit

Pyetja 347

Traktati i Paqes me Venedikun u lidh ndërmjet::

- A) Skënderbeut dhe Venedikut
- B) Lidhjes dhe Venedikut
- C) Shtetit shqiptar dhe Venedikut
- D) Nikollë Dukagjinit dhe Venedikut

Pyetja 348

Titulli zyrtar i Skënderbeut, ishte:

- A) Zot i qytetit të Krujës
- B) Monark i Shqipërisë
- C) Zot i Shqipërisë
- D) Princ i Shqipërisë

Pyetja 349

Për krijimin e shtetit Skënderbeut përdori:

- A) Lidhjen martesore
- B) Vullnetarizmin
- C) Dhunën
- D) Të gjitha së bashku

Pyetja 350

Shteti i përqendruar i Skënderbeut shtrihej veri-jug:

- A) Nga lumi Drin deri në lumin Devoll
- B) Nga Malësia e Dukagjinit në lumenjtë Devoll e Seman
- C) Nga Malësia e Gjakovës në lumin Shkumbin
- D) Apo asnjëra prej tyre

Pyetja 351

Organ i lartë pushteti në shtetin e Skënderbeut ishte:

- E) Kuvendi i princave shqiptarë
- F) Arka
- G) Ushtria
- H) Këshilli i Luftës

Pyetja 352

Traktati i Gaetës ishte një:

- A) Besëlidhje ushtarake
- B) Traktat paqe dhe ndihmë reciproke
- C) Traktat vasaliteti
- D) Pakt sulmi me forca të përbashkëta

Pyetja 353

Fitoret e Skënderbeut në rrethimin e dytë dhe të tretë të Krujës u përcaktua nga:

- A) Heroizmi i luftëtarëve shqiptarë
- B) Aftësitë luftarake të Skënderbeut
- C) Ndryshimi i taktikës së Skënderbeut
- D) Ndihamat e jashtme

Pyetja 354

Beteja e Ujit të Bardhë (Albulenë), solli:

- A) Fitoren e plotë të turqve
- B) Ishte disfata e dytë pas Sfetigradit
- C) Kapjen rob të Moisi Golemit
- D) Shpartallimin e ushtrisë osmane dhe zënien rob të Hamza Kastriotit

Pyetja 355

Timaret, ishin në pronësi të:

- A) Shtetit
- B) Timarliut
- C) Fshatarit raja
- D) Funkionarëve të mëdhenj të shtetit

Pyetja 356

Timaret, ishin në zotërimin e:

- A) Fshatarit raja
- B) Shtetit
- C) Spahiut
- D) Funkionarëve të mëdhenj të shtetit

Pyetja 357

Krijimi i çifligut si kategori e pronësisë mbi tokën, lidhet me:

- A) Gjysmën e parë të shek. XV
- B) Gjysmën e dytë të shek. XVI
- C) Gjysmën e parë të shek. XVI

D) Gjysmën e dytë të shek. XVI

Pyetja 358

Përpjekja e parë për bashkimin e vendeve të Ballkanit në luftën kundër osmanëve u kurorëzua në:

- A) Kuvendi e Dukagjinit
- B) Kuvendi e Kuçit
- C) Kuvendi e Blinishtit
- D) Kuvendi e Prokupjes

Pyetja 359

Krahinat autonome, në Shqipërinë e Jugut, qeveriseshin nga:

- A) Kapedanët
- B) Komandantët ushtarakë (bajraktarët)
- C) Këshilli i pleqve
- D) Kapedanët

Pyetja 360

Kuvendet ballkanike (1614-1620) pati si qëllim:

- A) Zgjerimin e territoreve të Pashallëkut të Shkodrës
- B) Pushtimin e krahinave, Elbasan-Tiranë
- C) Pushtimin e Malit të Zi
- D) Të luftohet kundër turqve osman

Pyetja 361

Pashallëku i Janinës kishte tiparet:

- A) E një shteti gjysmë autonom
- B) E një shteti autonom

- C) E një shteti të pavarur
- D) Shteti krejtësisht të varur

Pyetja 362

Në rrugën e forcimit të pushtetit të tij, Ali Pashë Tepelena u përkrahë nga:

- A) Borgjezia dhe fshatarët
- B) Tregtarët dhe zejtarët
- C) Familjet e reja feudale
- D) Familjet e vjetra feudale

Pyetja 363

I pari ndër pashallarët shqiptarë në shek. XVIII, që krijoi marrëdhënie të mira me shtetet e Evropës ishte:

- A) Veli Pashë Tepelena
- B) Mustafa Pashë Bushatlliu
- C) Veli Pashë Tepelena
- D) Mahmut Pashë Bushatlliu

Pyetja 364

I pari dokument i shkruar i gjuhës shqipe është:

- A) Muji dhe Halili (Cikli i kreshnikëve)
- B) Apologjia (P. Budi)
- C) Meshari (Gj. Buzuki)
- D) Çeta e Profetëve (P. Bogdani)

Pyetja 365

"Akademia e Re" në Voskopojë është shkollë e:

- A) Mesme në gjuhën latine
- B) Mesme në gjuhën greke

- C) Lartë në gjuhën greke
- D) Lartë në gjuhën sllave

Pyetja 366

Toleranca fetare e popullit shqiptar lidhej me:

- A) Paganizmin fetar
- B) Ndarjen fetare
- C) Mungesën e bindjeve fetar
- D) Apo asnjëra prej tyre

Pyetja 367

Rilindja kombëtare shqiptare është:

- A) Lëvizje politike
- B) Lëvizje politike e shoqërore
- C) Lëvizje arsimore e kulturore
- D) Kryengritje me armë

Pyetja 368

Akt themelues i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit ishte:

- A) Sheriati
- B) Talimati
- C) Karanamea
- D) Libri i vendimeve

Pyetja 369

Lidhja Shqiptare e Prizrenit u krijua në:

- A) 10 qershor 1878
- B) 13 qershor 1878

- C) 20 nëntor 1880
- D) 12 janar 1881

Pyetja 370

Lidhja Shqiptare e Prizrenit kishte karakter:

- A) Politiko-fetar
- B) Politiko-ushtarak
- C) Kulturoro-arsimore
- D) Ekonomiko-sociale

Pyetja 371

Veprimtaria e Lidhjes Shqiptare së Prizrenit në aspektin politik për mbrojtjen e trojeve shqiptare arriti kulmin e saj me:

- A) Hartimin e përkujtesës
- B) Mbrojtjen e Plavës dhe Gucisë
- C) Qeverinë e përkohshme
- D) Mbrojtjen e Hotit dhe Grudës

Pyetja 372

Lidhja Shqiptare e Prizrenit u shtyp në:

- A) Vjeshtë 1879
- B) Nëntor 1880
- C) Janar 1881
- D) Prill 1881

Pyetja 373

"Vilajetet e bashkuara" do të kishin si kryeqytet:

- A) Prizrenin
- B) Gjakovën
- C) Shkupin

D) Manastirin

Pyetja 374

"Kanuni i Përshtatshëm i Administratës Civile" ishte:

- A) Ligji për zgjedhjet e pushtetit lokal
- B) Ligji për organizimin e ri të administrativ të vendit
- C) Ligji për organizimin gjyqësor
- D) Ligji për organizimin e ushtrisë

Pyetja 375

Pleqësia ishte:

- A) Organi gjyqësor
- B) Dhoma e Lartë e Parlamentit
- C) Qeveria e parë e Shqipërisë së Pavarur
- D) Organ këshillues dhe kontrollues i Qeverisë

Pyetja 376

Cili prej pohimeve të mëposhtme është e saktë. Në Konferencën e Ambasadorëve në Londër, çështja shqiptare:

- A) Zuri një vend të vogël në krahasim me zërin e vendeve të tjera ballkanike
- B) U përkrah gjerësisht nga Italia, Franca dhe Austro-Hungaria
- C) U morr për bazë parimi i kombësisë
- D) U diskutua gjatë dhe statuti i saj politik ndryshoi në varësi të rrethanave

Pyetja 378

Njësitë administrative, sipas "Statutit Organik të Shqipërisë" ishin:

- A) Ejaletet
- B) Prefekturat, nënprefekturat, krahinat
- C) Sanxhakët, kazatë, naijet
- D) Prefekturat, sanxhakët, kazatë

Pyetja 379

Pozita juridike e Këshillit të Lartë ishte ajo e:

- A) Parlamentit
- B) Mbretit
- C) Qeverisë
- D) Asamblesë Kombëtare

Pyetja 380

Organ legjislativ sipas "Statutit të Lushnjes" ishte:

- A) Këshilli i Lartë
- B) Mbreti
- C) Qeveria
- D) Këshilli Kombëtar

Pyetja 381

Organizimi i shtetit shqiptar sipas "Statutit të Lushnjes" ishte ndërtuar sipas modelit të:

- A) Republikave presidenciale autoritare
- B) Monarkive kushtetuese parlamentare
- C) Monarkive burokratike e autoritare
- D) Republikanizmit dhe Parlamentarizmit

Pyetja 382

Parimi i ndarjes së pushteteve sipas "Statutit të Lushnjes" konsiston në:

- A) Në vendosjen e shtetit ligjor
- B) Ndarjen e fesë nga shteti
- C) Ndarjen e pushtetit gjyqësor nga administrata
- D) Ndarjen në pushtet legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor

Pyetja 383

Zgjedhjet e para parlamentare në Shqipëri:

- A) U zhvillua nën drejtimin e qeverisë së Sulejman Delvinës
- B) U zhvillua në 5 dhjetor 1920
- C) Për herë të parë votuan edhe gratë
- D) U zhvilluan në shkurt-mars 1921

Pyetja 384

Për përmasat që mori Lufta e Vlorës ishte një kryengritje popullore:

- A) E zonës së Labërisë
- B) E zonës së Mallakastrës
- C) Ndërkrahinore
- D) Mbarëkombëtare

Pyetja 385

Zgjedhjet e para parlamentare në Shqipëri:

- A) U zhvillua nën drejtimin e qeverisë së Sulejman Delvinës
- B) U zhvillua në 5 dhjetor 1920
- C) Për herë të parë votuan edhe gratë
- D) U zhvilluan në shkurt-mars 1921

Pyetja 386

Shqipëria u pranua në Lidhjen e Kombeve më:

- A) 17 janar 1920
- B) 5 maj 1920
- C) 17 tetor 1920
- D) 17 dhjetor 1920

Pyetja 387

Në Shqipëri lufta midis grupimeve politike në vitet 1921-1924, u përqendrua kryesisht në:

- A) I jepte të drejta ekonomike Italisë në Shqipëri
- B) I jepte të drejta ekonomike Greqisë në Shqipëri
- C) I njihte një pozitë favorizuese Austrisë
- D) Rinjihte Shqipërinë e pavarur sipas vendimeve të vitit 1913

Pyetja 388

Vendosja e marrëdhënieve me Bashkimin Sovjetik nga ana e qeverisë së Nolit:

- A) E thelloj besimin e shteteve anëtare të Lidhjes së Kombeve
- B) E thelloj mosbesimin dhe izolimin ndërkombëtar të Shqipërisë
- C) E ndihmoi qeverinë e Fan Nolit në fushën ekonomike
- D) E ndihmoi qeverinë të dilte nga izolimi ndërkombëtar

Pyetja 389

Sipas Statutit Themeltar të vitit 1925, Shqipëria u shpall:

- A) Republikë Presidenciale
- B) Republikë Parlamentare
- C) Monarki Parlamentare
- D) Republikë Gjysëmpresidenciale

Pyetja 390

Pengesa juridike për kalimin nga Republikë në Monarki ishte:

- A) Mospasja e një ligji të rregullt për këtë kalim
- B) Sanksionet që parashikon Statuti Themeltar për këtë kalim
- C) Mungesa e organit legjislativ për bërjen e këtij ndryshimi
- D) Neni 1, i Statutit Themeltar

Pyetja 391

Reformat juridike e viteve 1928-1933 hodhi bazat:

- A) E shtetit ligjor
- B) E shtetit burokratik
- C) E ekonomisë së tregut
- D) E ekonomisë së centralizuar
- E) Neni 1, i Statutit Themeltar

Pyetja 392

Në përdhën e Zogut, Ligji i Reformës Agrare u shpall më:

- A) 15 prill 1929
- B) 30 maj 1929
- C) 15 prill 1930
- D) 30 maj 1930

Pyetja 393

Statuti Themeltar i republikës së Shqipërisë i jepte fuqi të madhe:

- A) Presidentit të Republikës
- B) Parlamentit dhe Senatit
- C) Senatit dhe Presidentit
- D) Kryeministrit të Republikës

Pyetja 394

Në Jugosllavi, Reforma Agrare ndikoi tek shqiptarët në:

- A) Rinjohjen e pronave tokësore
- B) Shpronësimin e pronave tokësore
- C) Forcimin e identitetit kombëtar
- A) Forcimin e pozitave ekonomike

Pyetja 395

Për popullsinë çame, Konventa turko-greke e Lozanës ndikoj në:

- D) Shpërnguljen e grekëve në Turqi
- E) Shpërnguljen e shqiptarëve në Turqi
- F) Njohjen e pronave të grekëve në Turqi
- G) Njohjen e pronave të shqiptarëve në Turqi

Pyetja 396

Konferenca e Pezës u organizua nga:

- A) Partia e legalitetit
- B) Balli Kombëtar
- C) Partia Komuniste
- D) Grupet e ndryshme komuniste, që ekzistonin në atë kohë

Pyetja 397

Konferenca e Pezës u mbledh më:

- A) 8 nëntor 1941
- B) 16 shtator 1942
- C) 1-3 gusht 1943
- D) 24 maj 1944

Pyetja 398

Në Shqipëri, Fronti Nacionalçlirimtar përfaqësonte:

- A) Një aleancë ndërmjet Ballit dhe forcave komuniste
- B) Një aleancë ndërmjet Këshillit të Përgjithshëm Nacionalçlirimtar dhe Ballit Kombëtar
- C) Një organ i përbërë prej tetë vetash

D) Bashkimin e të gjitha forcave politike të vendit

Pyetja 399

Konferenca e Mukjes u kthye në mosmarrëveshje, sepse u vendos për:

- A) Bashkëpunim me Fuqitë e Mëdha
- B) Luftë të përbashkët ndaj okupatorit
- C) Formën e regjimit
- D) Bashkëpunimin me okupatorin

Pyetja 400

Si e gjykon vendimin e përbashkët për krijimin e "Komitetit të Shpëtimit të Shqipërisë":

- A) Përpjekje për ndarje pushtetesh
- B) Përpjekje për bashkim pushtetesh
- C) Përpjekje për paralelizëm pushtetesh
- D) Apo asnjëra prej tyre

Pyetja 401

Në thelb të programit të Ballit Kombëtar qëndronte lufta për një Shqipëri të:

- A) Lirë
- B) Etnike
- C) Demokratike
- D) Apo të tria së bashku

Pyetja 402

Marrëveshja Ribentrop-Çinano për ndarjen e viseve shqiptare në Jugosllavi u nënshkrua më:

- A) Mars 1941
- B) Prill 1941
- C) Maj 1941

D) Qershor 1941

Pyetja 403

Partia Komuniste e Shqipërisë doli hapur si forcë drejtuese e pushtetit në Luftën e Dytë Botërore në:

- A) Konferencën e Labinotit (të dytën)
- B) Kongresin e Përmetit
- C) Mbledhjen e Mukjes
- D) Pas çlirimit të Shqipërisë

Pyetja 404

Çlirimi i Shqipërisë u arrit nga:

- A) Kompromisi me okupatorit
- B) Lufta e popullit shqiptar
- C) Bashkimi i popullit shqiptar në frontin antifashistë
- D) Sukseset e Ushtrisë Nacionalçlirimtare

Pyetja 405

Krijimi i Shtabit kryesor të përkohshëm të Ushtrisë Nacionalçlirimtare Jugosllave për Kosovën dhe Rrafshin e Dukagjinit daton më:

- E) Pranverë 1943
- F) Verë 1943
- G) Vjeshtë 1943
- H) Dimër 1943

Pyetja 406

Më 16 shtator 1943, Lidhja e Dytë e Prizrenit vendosi:

- A) Krijimin e një Komitetit Ekzekutiv
- B) Bashkimin e Kosovës dhe viseve të tjera me Shqipërinë
- C) Organizimin politik për mbrojtjen e kufijve etnik
- D) Të tria së bashku

Pyetja 407

Pas Luftës së Dytë Botërore lidhur me të ardhmen e Kosovës, Konferenca e Bujanit u shpreh për parimin e vetëvendosjes:

- A) Për një autonomi të gjerë
- B) Për një bashkim me Shqipërinë
- C) Në kuadrin e Federatës Ballkanike
- D) Në krijimin e një republike më vete

Pyetja 408

Pas Luftës së Dytë Botërore në Shqipëri u ruajt ndarja administrative:

- A) Prefektura
- B) Nënprefektura
- C) Komuna
- D) Të tria së bashku

Pyetja 409

Pas zgjedhjeve të 2 dhjetorit 1945, forma e regjimit që u vendos në Shqipëri u quajt:

- A) Republikë Presidenciale
- B) Republikë Presidenciale-parlamentare
- C) Republikë Popullore
- D) Monarki Kushtetuese

Pyetja 500

Në vitin 1945, në Shqipëri vepron si grupime opozitare:

- A) "Bashkimi Shqiptar"
- B) "Bashkimi Demokratik"
- C) "Nacionaldemokrat"
- D) Grupi i Deputetëve

E) Të katër grupimet së bashku

Pyetja 501

Menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore, veprimtaria politike e opozitës kundërkomuniste ishte rrjedhojë:

- A) E luftës për pushtet ndërmjet forcave të ndryshme politike
- B) E prirjes për vendosjen e një regjimi demokratik-pluralist
- C) E prirjes për monopolizimin e njëanshëm të pushtetit nga PKSH
- D) E nxitjes nga jashtë

Pyetja 502

Sipas Statutit të miratuar në vitin 1946, organi më i lartë ekzekutiv në Shqipëri ishte :

- A) Kryetari i Komisionit të Kontrollit
- B) Qeveria
- C) Presidiumi
- D) Kryetari i Presidiumit

Pyetja 503

Reforma arsimore e vitit 1946, përcaktonte si strukturë:

- A) Arsimin bazë të detyrueshëm
- B) Arsimin unik
- C) Arsimin e mesëm
- D) Të tria së bashku

Pyetja 504

Reforma Agrare e viteve 1945-1946, e bënte fshatarin shqiptar:

- A) Pronarë të tokës
- B) Përdorues të tokës
- C) Pronarë dhe përdorues të tokës
- D) Apo asnjëra prej tyre

Pyetja 505

Ç'karakter pati Reforma Agrare e viteve 1945-1946, në Shqipëri:

- A) Kundërfeudal
- B) Kundërkapitalist
- C) Socialist
- D) Demokratik
- E) Apo në të gjitha aspektet

Pyetja 506

Ç'karakter kishin marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave në vitet 1945-1948:

- A) Marrëdhënie nga pozita të barabarta
- B) Marrëdhënie varësie e nënshtrimi
- C) Ndryshe nga pikat a) dhe b)
- D) Apo asnjëra prej tyre

Pyetja 507

Pas Luftës së Dytë Botërore për kapërcimin e gjendjes së rëndë, qeveria shqiptare pranoi të merrte ndihma nga:

- A) Shteti Amerikan
- B) Programi i O.K.B
- C) Programi UNRRA
- D) Plani Marshall

Pyetja 508

Në vitet 1945-1948, në fushën e arsimit vëmendja kryesore në masat e ndërmarra u përqendrua në:

- A) Ngritjen e arsimit teknik-profesional
- B) Ndërtimin e shkollave të reja në Shqipëri
- C) Zhdukjen e analfabetizmit në vend

D) Të tria së bashku

Pyetja 509

Kooperativa bujqësore si formë pronësie ishte pronë e:

- A) Administruar nga fshatarët
- B) Administruar nga shteti
- C) Grupit të fshatarëve
- D) Ndarë mes fshatit e qytetit

Pyetja 510

Nga pikëpamja ligjore likuidimi i institucioneve fetare në Shqipëri në vitin 1967 ishte:

- A) Në kundërshtim me Kushtetutën e aprovuar në vitin 1946
- B) Në përputhje me Kushtetutën e aprovuar më 1946
- C) Në përputhje me vullnetin e popullit
- D) I nxitur nga shtetet e Bllokut komunist

Pyetja 512

Traktati i Varshavës, kishte karakterin e një:

- A) Organizate ndërkombëtare me përfaqësues nga e gjithë bota
- B) Pakti ekonomik, politik, ushtarak
- C) Gjykatë ushtarake
- D) Pakti politik-ushtarak

Pyetja 513

Arsyet e prishjes së marrëdhënieve të Shqipërisë me Bashkimin Sovjetik ishin:

- A) Politike
- B) Ekonomike
- C) Të dyja bashkë
- D) Për faj të palës shqiptare

E) Për faj të palës sovjetike

Pyetja 514

Shkaku kryesor i daljes së Shqipërisë nga Traktati i Varshavës, ishte:

- A) Ekonomik
- B) Pushtimi i Çekoslovakisë nga trupat e Traktatit të Varshavës në vitin 1968
- C) Për faj të palës shqiptare
- D) Apo asnjëra prej tyre

Pyetja 515

Në ç'gjendje organizimi ishte artizanati në Shqipëri, në fillim të viteve '60:

- A) Kooperativist
- B) Shtetëror
- C) Privat
- D) Apo të tria së bashku

Pyetja 516

Nga se u karakterizua kolektivizimi i fshatit në Shqipëri, në vitet '60 - '70:

- A) Kooperativa të reja
- B) Zmadhimi i kooperativave ekzistuese
- C) Apo të dyja së bashku

Pyetja 517

Ku qëndron përmbajtja e reformës arsimore të viteve 1967-1969:

- D) Në masivizimin e arsimit
- E) Në lidhjen e mësimit me punën dhe jetën
- F) Në politizimin e ideologjizimin e përmbajtjes së lëndëve dhe të procesit edukativ

G) Apo të tria së bashku

Pyetja 518

Cili ishte tiparet kryesore të zhvillimit të letërsisë dhe të arteve në vitet '70:

- H) Rritja cilësore
- I) Ngritja e nivelit artistik
- J) Ideologjizimi i krijimtarisë
- K) Apo të tria së bashku

Pyetja 519

Si e gjykoni politikën e PPSH të "mbështetjes në forcat e veta":

- L) Besnikëri ndaj doktrinës marksiste-leniniste
- M) Realizëm në përcaktimin e burimeve të brendshme
- N) Mbivlerësim të potencialit të brendshëm
- O) Apo të tria së bashku

Pyetja 520

Në vitin 1995, Shqipëria u bë anëtare e:

- A) Këshillit të Evropës
- B) NATO-s
- C) OSBE-së
- D) Bashkimit Evropian

Pyetja 521

Në vitet 1950, shteti jugosllav për të realizuar qëllimet e tij përdori metodat e:

- A) Shpërnguljes
- B) Shkombëtarizimit
- C) Terrorit
- D) Të tria së bashku

Pyetja 522

Demonstratat e vitit 1968 në Kosovë, u zhvilluan nën parullat:

- A) Republikë
- B) Vetëvendosje
- C) Kushtetutë
- D) Universitet
- E) Të gjitha së bashku

Pyetja 523

Me Kushtetutën e vitit 1974, shqiptarëve të Kosovës u garantohej barazia në fushën e:

- A) Simboleve kombëtare
- B) Gjuhës
- C) Kulturës
- D) Flamurit
- E) Në të gjitha fushat së bashku

Pyetja 524

I pari lider i një partie jo komuniste në Kosovë ishte:

- A) Rexhep Qosja
- B) Ibrahim Rugova
- C) Hashim Thaci
- D) Veton Suroi

Pyetja 525

Kosova u shpall shtet i pavarur në vitin:

- F) 2005
- G) 2006
- H) 2007
- I) 2008

C. DIDAKTIKA E HISTORISË

Pyetja 526

Programi i lëndës mësimore të historisë përbëhet nga elementë:

- A) Qëllimi dhe objektivat
- B) Përmbajtja e lëndës
- C) Procedurat e mësimdhënies
- D) Mënyrat e vlerësimit
- E) Të gjitha elementët së bashku

Pyetja 527

Kurrikula e historisë përmban:

- A) Dimensionin teorik të përmbajtjes historike
- B) Parimet metodologjike
- C) Llojet e burimeve të kurrikulës me tiparet dhe karakteristikat e tyre
- D) Dimensionin njerëzor, aktorët e realizimit të saj, mësuesi dhe nxënësi
- E) Të gjitha elementët së bashku

Pyetja 528

Të mësuarit individual ka avantazhe për:

- A) Afrimin e nxënësit si subjekt aktiv i të mësuarit
- B) Përshtatjen e të mësuarit sipas mundësive, shkallës së formimit të prirjeve, interesave dhe veçorive të secilit nxënësi
- C) Për ta bërë nxënësin të vetorganizohet, të vetëkontrollohet e të korrigjohet
- D) Të tria së bashku

Pyetja 529

Puna në grup ka epërsi në nxitjen e:

- A) Aktivizimit dhe pjesëmarrjen e nxënësve në veprimtari
- B) Iniciativës së nxënësve
- C) Aftësive të nxënësve për të korrigjuar njëri-tjetrin
- D) Zhvillimi të aftësive drejtuese të nxënësve

E) Apo të gjitha epërsitë së bashku

Pyetja 530

Për zgjedhjen e metodës mësimore më të përshtatshme është e domosdoshme të njihet nga mësuesi:

- A) Përmbajtja e temës mësimore
- B) Përcaktimi i qartë i qëllimit të orës së mësimit
- C) Njohja e njohurive historike që kanë nxënësit
- D) Moshë e nxënësve
- E) Apo të gjitha faktorët së bashku

Pyetja 531

Përcaktimi dhe zgjedhja e metodës së mësimit varet nga:

- A) Përgatitja metodiko-didaktike e mësuesit të historisë
- B) Vendi ku do të zhvillohet mësimi
- C) Materialet burimore dhe mjetet didaktike
- D) Të tria së bashku

Pyetja 532

Mësimi i historisë, që të jetë një proces aktiv duhet të stimulojë tek nxënësit:

- A) Reflektet e kërkimit
- B) Përvojën e analizës kritike të ngjarjeve
- C) Informacionin që merr
- D) Të tria së bashku

Pyetja 533

Përgatitja e nxënësve për kërkim shkencor, kërkon nga mësuesi:

- A) Të bëjë planifikimin e kërkimit, duke patur parasysh se pa të nuk mund të zhvillohet një mësim
- B) Të përcaktoj qartë se çfarë do të zbulojë me kërkimin në fjalë

- C) Të ushtrojë e përgatisë nxënësit për kërkim, duke u dhënë atyre detyra për zgjidhje
- D) Të ndihmojë nxënësit që të zhvillojnë aftësitë për të kërkuar informacion dhe si të aftësohen në teknikat e kërkimit
- E) Apo të gjitha së bashku

Pyetja 534

Puna për përgatitjen dhe zhvillimin e ekskursionit mësimor lidhet me programimin e:

- A) Përfshirjes së veprimtarisë në planin kalendar të lëndës
- B) Zgjedhja dhe përcaktimi i monumentit apo burimit historik, që do të vizitohet, i cili duhet të ofrojë informacionin e domosdoshëm për arritjen e objektivave dhe detyrave mësimore të caktuara
- C) Hartimin e një plani të veçantë, ku do të përcaktohen objektivat mësimore që do të arrihen, njerëzit që do të përzgjidhen për zbatimin e tyre, bashkëpunimin me mësues të tjerë, diktuar nga lidhja ndërlëndore që ka tema e ekskursionit
- D) Marrja e autorizimit dhe miratimit të programit nga drejtori i shkollës
- E) Apo të gjitha së bashku

Pyetja 535

Brendia e lëndës së Historisë, mësohet në lidhje me konceptet dhe parimet kur:

- A) Mësuesi planifikon, duhet të shmangë dëshirën për të dhënë sa më shumë informacion
- B) Mësuesi planifikon, duhet të mos harrojë se detyra e formimit të parafytyrimeve konkrete historike është vështirë për vetë specifikën e lëndës që mësohet
- C) Mësuesi planifikon, i duhet të mendojë e të parashikojë për metodat e teknikat që do të përdorë për motivimin e nxënësve për t'i bërë ata të interesohen e të angazhohen për atë që mësuesi parashikon të realizojë
- D) Apo të tria së bashku

Pyetja 536

Metodat e hulumtimit, e zbulimit, e cila në krahasim me metodat tradicionale ka epërsi që:

- A) Nxiti te nxënësi të menduarit hipotetik dhe të pavarur, kritik dhe krijues

- B) Në veprimtari e sipër konceptet historike jo vetëm përpunohen më lehtë e më shpejtë, por edhe mbeten për një kohë të gjatë në kujtesën e nxënësve
- C) Nxiti sensin e kërkimit, analizës, sistemimit aq të domosdoshëm në të mësuarit konceptual
- D) Të tria së bashku

Pyetja 537

Për lëndës së historisë, është i njohur klasifikimi që i ndan mjetet e konkretizimit në:

- A) Mjete të konkretizimit lëndor
- B) Mjete të konkretizimit figurativ
- C) Mjete të konkretizimit simbolik
- D) Mjete teknike të konkretizimit
- E) Të gjitha mjetet konkretizuese

Pyetja 538

Televizioni, si mjet mësimor, gjen zbatim në veprimtarinë mësimore si:

- A) Mjet për organizimin dhe realizimin e plotë të veprimtarisë mësimore
- B) Mjet themelor i konkretizimit të mësimit të historisë
- C) Mjet plotësues në mësim
- D) Mjet i informacionit për përforcimin dhe plotësimin e njohurive të fituara
- E) Apo të gjitha së bashku

Pyetja 539

Planifikimi i mësimit ka si qëllim që të:

- A) Jap strukturën e mësimit, të organizimit dhe të shfrytëzimit të drejt të kohës sipas hapësirave dhe detyrave parashikuara

- B) Ndhimojë mësuesin të mendojë qartë dhe në mënyrë specifike për tipin e të mësuarit dhe të të nxënit, për metodat, strategjitë dhe teknikat që do të përdoren gjatë orës së mësimit
- C) Mbaj nën kontroll ritmin e orës së mësimit
- D) Planifikojë së të kontrollojë e të sigurohet se si nxënësit e kanë kuptuar mësimin
- E) Apo të gjitha qëllimet së bashku

Pyetja 540

Për të hartuar një plan të suksesshëm të mësimit, mësuesi duhet:

- A) Të zotërojë mirë materialin mësimor që do t'u mësoj nxënësve
- B) Të jetë i aftë të praktikojë një numër të madh metodash dhe teknikash të efektshme të mësimdhënies
- C) Të jetë i aftë të njohë nivelin teorik të nxënësve, aftësitë, prirjet, interesat e nxënësve për të kuptuar ngjarjet apo dukuritë historike
- D) Të njohë mirë pasurinë didaktike e materiale, mjetet mësimore, dokumentet historike që ka në qendrën burimore dhe kabinetet historike
- E) Apo të gjitha kërkesat së bashku

Pyetja 541

Me anën e organizimit të përsëritjeve të sistemuara, nxënësi mëson përmbajtjen e lëndës më shumë dhe më mirë, sepse:

- A) Harxhon më pak kohë e mund
- B) Mban në mend për një kohë më të gjatë njohuritë historike të nxëna
- C) Të dyja së bashku
- D) Apo asnjëra prej tyre

Pyetja 542

Gjatësia e intervaleve ndërmjet nxënies së dy përmbajtjeve varet nga:

- A) Veçoritë e lloji i përmbajtjes së temës që mësohet
- B) Vështirësitë e përmbajtjes

- C) Përgatitja dhe aftësia e nxënësve që mëson
- D) Gjatësia e përshtatshme e intervaleve të përsëritjes duhet të provohet në çdo kohë
- E) Apo të gjitha faktorët së bashku

Pyetja 543

Vlerësimi i nxënësit, parë në aspektin didaktik dhe të praktikës shkollore, është një proces që kalon në etapën e:

- A) Kontrollit, e cila nënkupton procesin e kërkimit dhe të mbledhjes së informacionit historik me qëllim që të nxirren përfundime për nivelin e të mësuarit dhe të nxënësit
- B) Matjes, e cila është procesi i krahasimit të sasisë së informacionit të panjohur në raport me njohuritë që duhet të përvetësojë nxënësi sipas programit
- C) Vlerësimit, gjatë të cilit përcaktohen vlerat mbi bazën e informacioneve të grumbulluara nga procesi i matjes
- D) Apo të gjitha etapat së bashku

Pyetja 544

Në varësi nga funksionet dhe qëllimet që i vë mësuesi, vlerësimi klasifikohet në kategorinë e:

- A) Vlerësimit formues, që synon të verifikoj, të vërë në dukje shkallën dhe cilësinë e njohurive historike të përpunuara dhe përvetësuara nga nxënësit
- B) Vlerësimit diagnostikues, e cila bëhet kryesisht nga aspekte të veçanta të përvetësimit të njohurive nga nxënësit
- C) Vlerësimit përmbledhës, e cila bëhet zakonisht në fund të një kreu, të një numri të caktuar temash apo në fund të një semestri ose të vitit
- D) Apo të gjitha vlerësimet së bashku